



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

Raport Vjetor i Progresit 2005

Shtator 2006

Parathënie

Objektivat kryesore të Qeverisë sime janë integrimi i Shqipërisë në BE dhe NATO, zhvillimi dhe konsolidimi i shtetit demokratik, vendosja e shtetit ligjor dhe çrrënjësja e sistemit të korrupsionit, rritja e shpejtë, e balancuar dhe e qëndrueshme e burimeve ekonomike dhe njerëzore si dhe një rol social i shtetit. Qeveria ime po punon drejt realizimit të këtyre objektivave madhore me një dedikim duke kërkuar një shkallë të lartë përgjegjësie për rezultatet që duhen arritur.

Për këtë arsye, jam shumë i kënaqur që të lancoj Raportin Vjetor të Progresit për vitin 2005, i cili do të shërbejë si dokumenti kryesor i monitorimit dhe vlerësimit të Qeverisë së Shqipërisë. Raporti është një komponent shumë i rëndësishëm i Sistemit të Planifikimit të Integruar, i cili u aprovua nga Këshilli i Ministrave në Nëntor 2005 në mënyrë që të sigurojë që proceset më të rëndësishme politike dhe financiare të Qeverisë të funksionojnë në mënyrë koherente dhe eficiente. Në këtë dokument ravijëzohen sfidat kryesore nëpër të cilat ka kaluar vendi që nga koha kur Qeveria ime erdhi në pushtet.

Duke filluar që nga viti që vjen, nëpërmjet Raportit Vjetor të Progresit do të bëhet monitorimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, e cila është në procesin e përgatitjes. Objektivat e këtij raporti do të jenë:

- Të vlerësojë progresin e bërë përkundrejt objektivat kryesore të Qeverisë;
- Të përdorë informacione statistikore për të bërë krahasimin e ecurisë së reformave në Shqipëri me ato të vendeve të tjera në rajon;
- Të shërbejë si bazë për të iniciuar diskutime të gjera mbi planet strategjike dhe axhendën e Qeverisë.

Përgatitja e Raportit Vjetor të Progresit 2005 u menaxhua nga Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj në Këshillin e Ministrave. Me këtë rast dua që të vlerësoj punën e Drejtorit si dhe stafit të këtij Departamenti për punën e shkëlqyer që kanë bërë në përgatitjen e tij.

Përveç kësaj, do të doja të falenderoja të gjitha Ministritë, INSTAT, Institutin e Shëndetit Publik si dhe Bankën e Shqipërisë për kontributin e tyre.

Në përfundim, do të doja të shprehja vlerësimin dhe falenderimin tim ndaj Departamentit për Zhvillim Ndërkombëtar (DfID) të Mbretërisë së Bashkuar për mbështetjen e madhe teknike që ka dhënë në përgatitjen e këtij dokumenti.

Kryeministri

Sali Berisha

Pasqyra e lëndës

Parathënie	1
1 Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim	3
2 Integrimi European dhe Euro-Atlantik	7
2.1 Proçesi i anëtarësimit në Bashkimin European	8
2.2 Proçesi i anëtarësimit në NATO	9
2.3 Bashkepunimi rajonal	10
3 Sistemi demokratik	11
3.1 Institucionet demokratike	12
3.2 Administrata publike	13
3.3 Decentralizimi	14
4 Shteti ligjor	15
4.1 Korrupsioni	16
4.2 Krimi i organizuar	17
4.3 Drejtësia	18
5 Zhvillimi ekonomik dhe njerëzor	19
5.1 Mjedisi i biznesit	20
5.2 Bilanci i pagesave	25
5.3 Infrastruktura	31
5.4 Arsimi	35
5.5 Shëndetësia	36
5.6 Strehimi	37
5.7 Mjedisi	38
6 Roli social i shtetit	39
6.1 Tregu i punës	40
6.2 Varfëria	41
6.3 Mbrojtja sociale	42
6.4 Fëmijët	43
6.5 Çështjet gjinore	44
6.6 Pabarazitë rajonale	45

Aneke

Aneksi 1 Disa tregues të përzgjedhur të monitorimit	46
---	----

Tabela dhe figura

Tabela 5.1.	Treguesit kryesorë makroekonomikë	19
Tabela A1.1	Objektivat kryesorë të SKZHES-së	46
Tabela A1.2	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, disa tregues të përzgjedhur	47
Figure 1.1	Kalendari i planifikimit të integruar	5

1 Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

Sistemi i Planifikimit të Integruar

Duke filluar që nga nëntori i vitit 2005, Sistemi i Planifikimit të Integruar (SPI) ofron një grup parimesh funksionale të cilat garantojnë që procesi i planifikimit dhe monitorimit nga ana e Qeverisë së Shqipërisë të kryhet në mënyrë koherente, eficiente dhe të integruar. SPI nuk përbën një sistem të ri apo të veçuar planifikimi. Dy janë proceset ekzistuese që mbulojnë të gjitha aktivitetet qeveritare:

- Një proces kombëtar afatmesëm deri afatgjatë për planifikimin strategjik, i cili quhet Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) (2007-2013), dhe përcakton përparësitë dhe synimet strategjike. SKZHI-ja pritet që të miratohet në fillim të vitit 2007 dhe do të zëvendësojë Strategjinë Kombëtare për Zhvillim Ekonomik dhe Social (SKZHES).
- Një proces buxhetor afatmesëm, i quajtur Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA), i cili kërkon që çdo ministri të përgatisë një plan tre-vjeçar brenda një tavani shpenzimesh për të arritur objektivat e politikës së saj në përputhje me SKZHI-në. Procesi i PBA-së funksionon që në vitin 2000 dhe lidhet në mënyrë direkte me procesin e buxhetimit vjetor.

Në proceset e buxhetimit dhe planifikimit strategjik do të pasqyrohen katër procese themelore:

- Integrimi Europian dhe Euro-Atlantik, domethënë zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe Planit të Aksionit për Anëtarësim në NATO
- Programi Qeveritar
- Menaxhimi i investimeve publike
- Menaxhimi i ndihmës së huaj

Përsa i përket planifikimit strategjik, ndryshimet që po paraqiten kanë për qëllim të trajtojnë tri kufizimet e procesit të mëparshëm të renditura më poshtë:

1. Procesi i planifikimit strategjik nuk ishte gjithëpërfshirës.

Sipas SPI-së do të ketë një hierarki dokumentash të planifikimit strategjik. SKZHI-ja, një strategji kombëtare e vetme, do të mbështetet mbi një kuadër të gjerë strategjish sektoriale dhe do të udhëhiqet nga një grup i përzgjedhur strategjish ndërsektoriale. Strategjia kombëtare do të shfaqet si një sintezë e dokumentave të strategjive sektoriale të përgatitura për të gjithë sektorët, ndryshe nga SKZHES-ja, e cila u përgatit për një numër të kufizuar sektorësh. Integrimi europian dhe proceset e planifikimit për anëtarësimin në NATO do të përfshihen plotësisht në strategjinë e re kombëtare .

2. Procesi i planifikimit strategjik nuk u drejtua në masën e duhur nga nga Këshilli i Ministrave.

Në kuadër të SPI-së, ministritë e linjës do të jenë përgjegjëse për përgatitjen e strategjive sektoriale që përmbushin standartet e cilësisë. Veç kësaj, strategjitë sektoriale duhet të paraqesin lidhjet midis politikave të cilave u janë përlllogaritur kostot, dhe synimeve që ministritë kërkojnë të arrijnë. Kjo do t'u japë mundësi Kryeministrit dhe ministrave të vendosin drejtimet strategjike brenda një kuadri të shëndoshë fiskal në fillim të procesit të planifikimit vjetor.

3. Procesi i planifikimit strategjik ishte i shkëputur nga buxhetimi afatmesëm.

Në kuadër të SPI-së, planifikimi strategjik dhe ai buxhetor janë përbërës të një sistemi të vetëm të menaxhimit të shpenzimeve publike:

- Ministritë e linjës vendosin në strategjitë e tyre sektoriale synime afatmesme deri afatgjata, të cilat janë identike me synimet e përcaktuara në format përgatitore të PBA-së për çdo program buxhetor, dhe vlerësojnë gjerësisht burimet e nevojshme për të arritur këto synime.

- Departamenti i Bashkëndimit të Strategjive dhe Koordinimit Strategjik të Ndhmës së Huaj, në bashkëpunim me Departamentin e Politikës dhe Analizës së Buxhetit dhe Departamentit Makroekonomik, përgatisin opsionet për akordimin, në vija të trasha, të burimeve ndërsektoriale për Komitetin e Planifikimit Strategjik në fillim të çdo cikli të PBA-së.
- Komiteti i Planifikimit Strategjik dhe Këshilli i Ministrave marrin vendime për shpërndarjen ndërsektoriale të burimeve në kuptimin e gjerë për periudhën afatmesme në mënyrë që të nisë procesi përgatitor i PBA-së.

Figure 1.1 tregon ciklin vjetor që integron proceset kryesore planifikuese dhe financiare. Kalendari u përgatit për herë të parë në vitin 2005 dhe përcaktoi afatet kohore për vendimet dhe përgatitjen e dokumentave kryesore për institucionet qendrore si dhe Ministrat e Linjës për vitin 2006.


Proçesi përgatitor i SKZHI-së

Proçesi përgatitor i SKZHI-së është skicuar sipas një udhëzimi të nxjerrë me një Urdhër të Kryeministrit. Ai përfshin një grup standartesh sipas të cilave do të përgatiten dhe miratohen strategjitë kombëtare, sektoriale dhe ndërsektoriale. Komiteti i Planifikimit Strategjik pranë Këshillit të Ministrave ka miratuar listën e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale që do të përgatiten dhe që do të shërbejnë si themelet mbi të cilat do të hartohet SKZHI-ja.

Në bazë të planeve për hartimin e strategjive, të miratuara së bashku me Departamentin e Bashkëndimit të Strategjive dhe Koordinimit Strategjik të Ndhmës së Huaj pranë Këshillit të Ministrave në qershor të vitit 2006, ministrat e linjës do të përgatisin strategji sektoriale dhe ndërsektoriale nën udhëheqjen e Grupeve përkatëse të Punës për Strategjinë, Buxhetin dhe Integrimin. Strategjitë e hartuara do të paraqiten në tetor të vitit 2006 për t'u shqyrtuar nga Komiteti i Planifikimit të Strategjive të Këshillit të Ministrave. Në varësi të plotësimit të standarteve të vendosura në udhëzime, draftet e këtyre strategjive mund të paraqiten si drafte maket ose të plota.

Në varësi të formës së dokumentave të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale (maket apo të plota) që do të dorëzohen në tetor 2006, Departamenti i Bashkëndimit të Strategjive dhe të Koordinimit Strategjik të Ndhmës së Huaj do të bashkërendojë përgatitjen e projekt-SKZHI-së. Versioni përfundimtar i SKZHI-së do t'i paraqitet Komitetit të Planifikimit Strategjik për diskutim dhe shqyrtim. SKZHI-ja do të miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe do t'i paraqitet Parlamentit brenda tremujorit të parë të vitit 2007. Gjatë gjithë vitit 2007, ato ministri të linjës që kanë paraqitur vetëm strategji sektoriale maket do të vazhdojnë punën deri në përfundimin e tyre.

Figure 1.1 Kalendar i planifikimit të integruar



Proçesi monitorues i SKZHI-së

Sipas SPI-së, Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit Strategjik të Ndhmës së Huaj pranë Këshillit të Ministrave do të jetë përgjegjës për një raport vjetor i cili:

- do të vlerësojë ecurinë e zbatimit të strategjisë, kryesisht përsa i përket prirjeve të nivelit të lartë, ndërkohë që treguesit e rezultateve do të miratohen së bashku me ministritë e linjës. Këta tregues duhet të jenë në përputhje me masterplanin kombëtar statistikor të INSTAT-it
- do të përdorë informacione të tjera statistikore në dispozicion në mënyrë që të analizojë prirjet afatgjata dhe të krahasojë Shqipërinë me vendet e tjera në rajon
- do të identifikojë në mënyrë të përzgjedhur çështjet që kanë rëndësi kritike për proçesin e arritjes së objektivave afatgjata të vendit dhe që do të jenë baza për diskutime më të gjera

Raporti Vjetor i Progresit:

- nuk paraqet një strategji të mirëfilltë, pasi ky rol do të mbulohet nga dokumenti i SKZHI-së
- nuk përvijon një kuadër që hedh shikimin nga e ardhmja, pasi kjo ofrohet në dokumentin e PBA-së; ky i fundit nën përgjegjësinë e Ministrisë së Financave
- nuk zëvendëson raportimin vjetor të rezultateve kryer nga ministritë e linjës që përbën një pjesë të sistemit të raportimit buxhetor.

Qëllimi dhe struktura e Raportit të Progresit

Proçesi për përgatitjen e SKZHI-së nxjerr në pah angazhimin e Qeverisë së Shqipërisë për të paraqitur një strukturë gjithëpërfshirëse të planifikimit strategjik duke përfshirë të gjitha fushat e aktivitetit të saj dhe që do të zëvendësojë qasjen e mëparshme që ka qenë e copëzuar. Megjithatë, SKZHI-ja nuk është formuluar dhe miratuar ende, ashtu siç nuk është përcaktuar ende grupi i treguesve të nivelit të lartë që do të përdoret për të monitoruar zbatimin e saj. Prandaj, Raporti i Progresit për vitin 2005 përfaqëson një gjendje tranzicioni drejt krijimit të një mjeti të përhershëm monitorues:


- Ai nënvizon ndryshimet që po ndodhin nëpërmjet SPI-së dhe SKZHI-së, në veçanti përparësinë maksimale që i jepet integritetit evropian dhe Euro-Atlantik
- Ai synon të mbështesë proçesin e përzgjedhjes së treguesve dhe objektivave që do të ndiqen gjatë përgatitjes së SKZHI-së, dhe të tërheqë vëmendjen tek produktet e sistemit statistikor kombëtar

Në këtë raport i kushtohet një faqe secilit prej grupeve të çështjeve të përzgjedhura. Çdo faqe ndjek përgjithësisht këtë format: gjysma e sipërme e faqes përmban një paraqitje grafike të një treguesi statistikor; teksti në gjysmën e poshtme përcakton treguesin, paraqet rrjedhojën kryesore të politikave dhe ofron një raport përshkruar për veprimet që qeveria ka ndërmarrë apo ka planifikuar të ndërmarrë për të trajtuar çështjen e politikës në fjalë.

Duhet theksuar se treguesit në Raportin Vjetor të Progresit për vitin 2005 janë të përkohshëm dhe nuk zëvendësojnë aspak treguesit që do të përdoren për të monitoruar zbatimin e SKZHI-së.

Raporti i Progresit për vitin 2005 përfshin të gjithë treguesit kryesorë të SKZHES-së për arsye vazhdimësie, duke qenë se këta tregues janë përfshirë në tri raportet e mëparshme mbi ecurinë dhe duke qenë se SKZHES-ja përbën një prej bazave ku mbështetet buxheti i vitit 2006.

2 Integrimi European dhe Euro-Atlantik



	Shqipëria 2003-04	Vendet e Europës Qëndrore dhe Lindore 10 vjet përpara anëtarësimit		
		Minimumi	Mesatarja	Maksimumi
1. Produkti i brendshëm bruto (PBB) për frymë	€1970	Lituania €977	€2360	Sllovenia €6099
2. Pjesa e punësimit jo-bujqësor	57%	Rumania 62%	85%	Rep. çeke 93%
3. Bilanci tregtar: eksporte/importe	24%	Sllovakia 74%	88%	Bullgaria 109%
4. Shkalla e regjistrimit në arsimin e mesëm	42%	Letonia 60%	78%	Polonia 96%
5. Shteti ligjor	25%	Rumania 44%	63%	Hungaria 75%

Burimet: (1-3) PBB-ja përkatëse për frymë: Eurostat; Ameco; IMF dhe INSTAT për Shqipërinë; (4) Treguesit Rajonalë Edstats të EAQ-s të Bankës Botërore; (5) Treguesit e Qeverisjes së Bankës Botërore

Shënime: Në Grupin e vendeve të Europës Lindore dhe Qëndrore përfshihet 8 vendet të cilat u bënë anëtare të Bashkimit European në vitin 2004 (mesataret për vitin 1994) plus Bullgaria dhe Rumania, të cilat do të bëhen anëtare të Bashkimit European në vitin 2007 (mesataret për vitin 1997). Mesataret për të dy grupet janë llogaritur për vitet 1994 dhe 1997 përveç treguesit të shtetit ligjor, i cili bazohet në vitin 1996 për të dhjetë vendet.

Procesi i integritimit në Bashkimin European është shumë kompleks. Grafiku i mësipërm tregon pozicionin e Shqipërisë në vitet 2003 - 2004 (kolona me ngjyrë të kuqe) në pesë fusha socialekonomike krahasuar me vendet anëtare të BE-së dhjetë vjet përpara anëtarësimit të tyre (viza vertikale tregon diapazonin e performancës për secilin prej indikatorëve). Është fakt se Shqipëria është në pozita më të mira përse i përket të ardhurave për kokë krahasuar me disa prej vendeve që janë bërë vende anëtare së fundmi, në fillim të procesit të tyre të anëtarësimit, por pozicionohet më keq në fusha të tjera si psh regjistrimi i nxënësve në shkollat e mësme dhe shtetit ligjor.

2.1 PROÇESI I ANËTARËSIMIT NË BASHKIMIN EUROPIAN

Më 12 qershor 2006, Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit. Raporti i Stabilizim-Asocimit për vitin 2005 thekson se në përgjithësi Shqipëria kishte bërë "disa përparime në zbatimin e prioritetëve afatshkurtra të Partneritetit European" porse zbatimi i duhur ishte "pënguar nga vështirësia në mundësimin e burimeve, e ndërthurur kjo në disa raste me mungesë të vullnetit politik". Pikat e mëposhtme ishin më të spikaturat në raport:

Situata politike	
Demokracia dhe shteti ligjor	"Reforma legjislative e sistemit gjyqësor e ka sjellë Shqipërinë më afër standarteve të BE-së" por "duhet të shndërrohet më shpejt dhe më me gatishmëri në arritje konkrete"
Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve	U krijua një Komitet Shtetëror i Posaçëm për Pakicat por punonjësit e kontrollit të zbatimit të ligjit duhet të jenë të ndërgjegjshëm për detyrimet e tyre në lidhje me të drejtat e njeriut
Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar	"Shqipëria ka mbajtur marrëdhënie të mira rajonale përmes marrëveshjeve të tregtisë së lirë me fqinjët e saj që nuk janë anëtarë të BE-së dhe përmes pjesëmarrjes në disa nisma rajonale shumëpalëshe"
Situata ekonomike	
Ekonomia e tregut të lirë, reformat strukturore dhe menaxhimi publik financiar	"Shqipëria ka qenë e suksesshme në ruajtjen e një strukture makroekonomike të qëndrueshme" por "siguria e pronësisë ka nevojë të ngutshme të përmirësohet përmes zbatimit të plotë dhe në kohën e duhur të ligjit të ri mbi kthimin e pronave"
Standartet europiane	
Tregu dhe tregtia e brendshme	"Janë bërë mjaft përmirësime në fushën e doganës, me përbushjen e objektivave të të ardhurave buxhetore, me përmirësimin e kapacitetit administrativ, uljen e shkallës së ndërrimit të stafit, me një bashkëpunim më të mirë me policinë dhe zbatimin e sistemit ASYCUDA" por "duhet të bëhen përmirësime më konkrete nga shërbimet doganore në luftën kundër kontrabandës dhe trafikimit."
Politikat sektoriale	"Shqipëria ka bërë përparime në zbatimin e strategjisë së saj për energjitikën ... dhe angazhimeve të ndërmarra në kuadër të procesit të tregut rajonal të energjisë që çon drejt Traktatit të Komunitetit për Energjinë"
Bashkëpunimi në çështjet e brendshme dhe të drejtësisë	"Legjislacioni i ri për luftën kundër krimit të organizuar duhet të ndiqet nga ... arritje konkrete në arrestimin dhe ndjekjen penale të autorëve të krimit dhe konfiskimin e pronave"

Pikat e mëposhtme u identifikuan si përparësi kyçe në Partneritetin European të vitit 2005:

- "Të arrihen rezultate konkrete në luftën kundër krimit të organizuar, në veçanti duke përdorur të gjitha dispozitat e ligjeve të reja për krimin e organizuar dhe duke përshpejtuar zbatimin e masave që bazohen në veprime kundër krimit të organizuar
- Të zbatohet dhe të përditësohet plan-veprimi anti-korrupsion i vitit 2004-2005 dhe i rekomandimeve të Raporteve Vlerësuese të Grupit të Shteteve të Këshillit të Europës Kundër Korrupsionit (GRECO)
- Të zbatohet legjislacioni ekzistues për kthimin/kompensimin e pasurive të patundshme. Në veçanti, të përshpejtohet si regjistrimi fillestar i pronave, ashtu edhe shqyrtimi i kërkesave për kthim. Njëkohësisht duhet të sigurohet që strategjitë dhe mekanizmat për kthimin e pronave të jenë të qëndrueshme.
- Duke marrë parasysh standartet e BE-së, t'i kushtohet kujdes lirisë së shtypit, veçanërisht duke përshpejtuar miratimin e legjislacionit të përshtatshëm për median e shkruar dhe duke përmirësuar legjislacionin për median elektronike.
- Të vazhdohet një forcim i mëtejshëm i qeverisjes në sektorin publik, sidomos në aspektet e menaxhimit të investimeve publike, planifikimit dhe ekzekutimit."

2.2 PROÇESI I ANËTARËSIMIT NË NATO


Sipas Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Jashtme, arritjet më kryesore në rrugëm për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO gjatë vitit 2005 janë:

Kushtet politike	
<p>Konsolidimi i kontrollit civil demokratik ne Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH)</p> <p>Kontributi i Shqipërisë në misionet paqeruajtëse</p>	<p>Ka progres thelbësor në drejtim të reformimit të sistemit të mbrojtjes të FARSH-it.</p> <p>Është shfrytëzuar me efikasitet buxheti i mbrojtjes miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Në bazë të Strategjisë së Sigurisë dhe Strategjisë Ushtarake, buxheti për mbrojtjen duhet të arrijë në 2% te GDP-së deri në vitin 2010.</p> <p>Vendi ynë ka misione në tre vende:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në misionin ISAF në Afganistan Shqipëria merr pjesë me një kontingjent prej 22 trupash; në kuadër të " Kartës së Adriatikut" po kryen misionin raundi i dytë i Ekipit të Përbashkët Mjekësor; si dhe 9 kadro janë të angazhuar në ketë mision në kuadrin e Shtabit të SEEBRIG-ut. • Në misionin "Liria e Irakut" kontribuon një efektiv prej 120 trupash. • Në misionin ALTHEA të BE-së në Bosnje dhe Hercegovinë kontribuon një efektiv prej 70 trupash.
Kushtet ushtarake	
<p>Reforma e mbrojtjes dhe realizimi i objektivave për anëtarësim në NATO</p> <p>Zbatimi i Sistemit të Planifikimit, Programimit, Buxhetimit dhe Ekzekutimit në menaxhimin e burimeve të mbrojtjes</p> <p>Shkatërrimi i municioneve të tepërta, armëve të vogla dhe atyre të lehta</p>	<p>Ka progres në konsolidimin e një strukture të re të FARSH-it, më të vogël, por më profesioniste dhe në përputhje me standartet e NATO-s. Paketa e re e Objektivave të Partneritetit është në procesin e zbatimit.</p> <p>Të gjitha burimet janë dhënë atje ku janë më të nevojshme: u hoq nga struktura e forcës komponenti rezervist dhe u zëvendësuan nga Komandat e Mbështetjes Rajonale; u hoqën nga përdorimi avionët me krahë fiks dhe po punohet për shkatërrimin/shitjen e tyre dhe zëvendësimin me helikopterë.</p> <p>Janë vendosur 4 njësi në dispozicion të NATO-s në kuadrin e zbatimit të Konceptit për Kapacitetet Operacionale (OCC).</p> <p>Ministria e Mbrojtjes është në procesin e rivlerësimit të strukturës së Forcës, me asistencën e SHBA-së dhe të Komandës së NATO-s për Transformimin (ACT).</p> <p>U përgatit Plani Afatgjate i Zhvillimit, që do të mbulojë periudhën 2007-2015. Në kuadrin e procesit të profesionalizimit, veçanërisht në njësitë prioritare, Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Ministrinë e Financës dhe Ministrinë e Drejtësisë, po hartojnë një strategji ligjore për përfshirjen e pagave të ushtarakëve profesionistë në fondin buxhetor të qeverisë për mbrojtjen. Po punohet për reduktimin e shpenzimeve të personelit dhe me tepër investime në drejtim të pajisjeve, stërvitjes e modernizimit</p> <p>Janë shkatërruar 28.000 ton municione që kane dalë tepër si rezultat i heqjes së komponentit rezervist. Po punohet dhe në kuadrin e marrëveshjeve dypalëshe me vendet e Aleancës për zhvillimin e programeve të eliminimit të municioneve të tepërta dhe armëve të vogla e të lehta.</p>

Të gjitha përpjekjet kanë qenë të orientuara drejt sigurimit të mbështetjes së Aleancës dhe vendeve anëtare si dhe në përcaktimin e një kuadri të qartë të afateve kohore të zgjerimit të NATO-s. Është bërë tashmë e qartë që Shqipëria është kandidatë potenciale për tu anëtarësuar në NATO dhe ftesa mund të realizohet në Summit-in e NATO-s të vitit 2008.

2.3 BASHKEPUNIMI RAJONAL

Tregtia me vendet e Europës Juglindore (EJL)




Burimi: Qendra Shqiptare për Tregtinë Ndërkombëtare, raporte të ndryshme vjetore të tregtisë së jashtme

Ka të paktën tri dimensione të bashkëpunimit rajonal:

- **Politik:** Marrëdhëniet e ngushta me vendet fqinjë janë një nga shtyllat të politikës së jashtme të Shqipërisë. Është zhvilluar dialog politik për çështje me interes të përbashkët. Në vitin 2005 vijuan përmirësime të mëtejshme në klimën e përgjithshme politike dhe kjo u shoqërua me kontakte intensive, përgjithësisht në rrafshin e bashkëpunimit shumëpalësh. Përmes frymës së dialogut e të mirëkuptimit me të gjithë faktorët rajonalë, politika shqiptarë e jashtme ka synuar promovimin e imazhit të një Shqipërie faktor stabiliteti e paqeje në rajon. Ndër të tjera, kjo ka gjetur shprehje edhe në mesazhet moderuese dhe konstruktive që ajo ka përcjellë tek bashkëkombasit e saj në vendet fqinje dhe të rajonit.
- **Ekonomik:** Siç është theksuar kohët e fundit nga Komisioni Europian, në fusha si tregtia, energjia dhe transporti, “nuk ka rrugë tjetër përveçse nisjes së bashkëpunimit intensiv rajonal si e vetmja mënyrë realiste për të ecur përpara”:
 1. Liberalizimi i *tregtisë* rajonale po përparon. Figura e mësipërme tregon tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të saj fqinjë. Eksportet në vendet fqinjë janë rritur nga 36 në 58 milion dollarë, ndërsa importet u rritën nga 58 në 92 milion dollarë gjatë periudhës 2003-2005. Megjithatë, edhe pse kanë hyrë në fuqi marrëveshjet dypalëshe të tregtisë së lirë, tregtia ndërmjet këtyre vendeve është ende modeste. Në fakt, tregtia me vendet fqinjë u ul në vitin 2005 si pjesë e tregtisë në total. Në këtë drejtim, vendet e rajonit po shqyrtojnë mundësinë për të zëvendësuar marrëveshjet dypalëshe me një marrëveshje unike të tregtisë së lirë nëpërmjet ndryshimit dhe zgjerimit të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë për Europën Qendrore (CEFTA).
 2. Shqipëria ishte një ndër vendet që firmosën traktatin që krijonte Komunitetin e Energjisë së Evropës Jug-Lindore në Tetor të vitit 2005. Ky traktat do të shërbejë për të vendosur një kuadër të vetëm rregullimi për tragtimin e energjisë dhe eventualisht do të përmbajë të gjitha direktivat e BE-së.
 3. Po bëhen përparime të rëndësishme në rindërtimin e infrastrukturës ku po merren hapa drejt një strategjie të integruar të *transportit* rajonal, së bashku me rrjetet trans-europiane.
- **Siguria:** Shumë prej çështjeve urgjente, siç është krimi i organizuar, menaxhimi i integruar i kufirit dhe migrimi i jashtëligjshëm, mund t’u jepet zgjidhje vetëm duke vepruar konkretisht.

3 Sistemi demokratik

Shprehja e mendimit dhe llogaridhënia



Burimi: Treguesit Qeverisë, Instituti i Bankës Botërore

Qeveria e Shqipërisë ka për qëllim vënien në zbatim të një programi gjithëpërfshirës i cili pasqyron një sërë reformash institucionale dhe ligjore të orientuara drejt përbushjes së standarteve europiane, në mënyrë që të mund të arrihen rezultate të qarta në përpjekjet për një sistem demokratik të konsoliduar. Matja e këtyre perceptimeve me saktësi përbën një proces mjaft të vështirë. Një grup treguesisht të cilët janë të miratuar përgjithësisht, është ai i Treguesve të Qeverisë, të cilët përllogariten çdo dy vjet nga Instituti i Bankës Botërore. Grafiku i mësipërm raporton treguesin e shprehjes së mendimit dhe të llogaridhënies, i cili përfshin "aspekte të ndryshme të procesit politik, të të drejtave civile, të drejtave të njeriut dhe atyre politike, duke matur shkallën në të cilën qytetarët e një vendi janë të aftë të marrin pjesë në zgjedhjen e qeverive".

Është e domosdoshme të theksohet se në ndryshim nga tregues të tjerë në këtë raport, treguesit e qeverisë janë subjektivë. Ose, me fjalë të tjera, këta tregues janë bazuar në opinione ekspertësh dhe profesionistësh, në perceptime dhe këndvështrime të studiuara, të cilat janë mbledhur nëpërmjet teknikave statistikore. Për rrjedhojë, treguesit rrezikojnë të jenë të njëanshëm sa i përket burimit të opinionit. Këto të dhëna janë marrë gjatë një periudhe të gjatë kohore dhe jo sistematikisht. Pavarësisht, ky tregues është mjaft informativ në paraqitjen e prirjeve gjatë një periudhe të gjatë kohore dhe mund të vihet në përdorim për të kryer krahasime ndërmjet shteteve. Nga pikëpamja e këtij treguesi, ndryshe nga ajo e treguesve të tjerë në këtë raport, vërehet se Shqipëria në fakt gjendet në një pozicion më të mirë se Bosnje-Hercegovina dhe Maqedonia.

3.1 INSTITUCIONET DEMOKRATIKE

Zgjedhjet parlamentare u zhvilluan në korrik të vitit 2005 mbi bazat e një Kodi Elektoral të sapo rishikuar. Edhe pse i gjatë dhe jo pa probleme, procesi zgjedhor respektoi parimet themelore demokratike. Sipas Raportit të Stabilizim-Asocimit të vitit 2005, "këto zgjedhje parlamentare ishin thellësisht të vlefshme dhe çuan në një kalim të qetë pushtetesh".

Misioni i Mbikqyrjes së Zgjedhjeve i OSBE/ODIHR-it raportoi se procesi i zgjedhjeve u karakterizua nga një numër zhvillimesh pozitive: u drejtua sipas një kodi elektoral të përmirësuar, dhe në një atmosferë përgjithësisht të qetë; ishin regjistruar një spektër i gjerë partish dhe kandidatësh, duke u ofruar votuesve një larmi zgjedhjesh; partitë premtuan se do të zbatonin një kod etik, i cili ndihmoi në vendosjen e standarteve të fushatës; mbulimi i mediave ishte përgjithësisht i ekuilibruar; Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve dhe Kolegji Zgjedhor i përmbushën rolet e tyre në mënyrë transparente dhe profesionale.

Megjithatë, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve OSBE/ODIHR tregoi gjithashtu se janë një numër çështjesh të cilave duhet t'u jepet zgjidhje, duke përfshirë probleme teknike dhe administrative, shqetësime që kanë të bëjnë me votimin taktik, heqjen e mundshme të së drejtës së votës së një numri studentësh, një mungesë përmirësimi në pjesëmarrjen e gruas në çështjet publike dhe, mbi të gjitha, një nevojë për një përmirësim të mëtejshëm të listave të votuesve. Për pikën e fundit, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve OSBE/ODIHR shprehu rekomandimet e mëposhtme:

"17. Për të përmirësuar saktësinë e listave të votuesve, kërkohet urgjentisht një përpjekje e vazhdueshme për të ruajtur dhe përmirësuar saktësinë e regjistrave të gjendjes civile. Duhet t'i jepet përparësi përgatitjes së një sistemi adresash për godinat dhe pronat e tjera të patundshme. Përparësi të tjera përfshijnë ndreqjen e emrave të shkruar gabim, të dhënave të pasakta, të ashtuquajturat 'regjistrimet 999' dhe regjistrimet e mundshme të shumëfishta brenda dhe përtej kufijve administrativë të njëjësive vendore.

18. Në këtë pikë, zyrat e gjendjes civile kanë nevojë për burimet e duhura financiare, teknike dhe njerëzore. Puna për përditësimin e regjistrave të gjendjes civile dhe më pas për listat e votuesve do të kërkojë një angazhim afatgjatë në qoftë se autoritetet shqiptare duan të kenë gati një sistem plotësisht funksional të gjendjes civile (dhe rrjedhimisht të regjistrimit të votuesve) për zgjedhjet parlamentare të vitit 2009.

19. I duhet dhënë një rëndësi e veçantë përcaktimit të një mënyre të përshtatshme për identifikimin e votuesit, e cila nuk lë vend për abuzime. Nëse qeveria dëshiron të paraqesë dokumenta të reja identifikimi, më parë duhet të zhvillohet një proces konsultimi me bazë të gjerë. Përsa kohë që 'çertifikatat e lindjes' janë një formë e pranueshme e identifikimit të votuesit, autoritetet qendrore duhet të sigurojnë që zyrat e gjendjes civile të mbajnë të dhëna të sakta zyrtare mbi çertifikatat e lëshuara për të gjitha qëllimet, në veçanti për ato zgjedhore, dhe këto të dhëna të jenë të disponueshme publikisht."

Në tetor 2005, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve mori raportin përfundimtar të Misionit Vëzhgues të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR, për zgjedhjet parlamentare të 3 korrikut. Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve i mirëpriti vlerësimet e paraqitura në raport dhe është i angazhuar në përmbushjen e të gjitha rekomandimeve të botuara në të.

3.2 ADMINISTRATA PUBLIKE

Në Raportin e vitit 2005 të Stabizim-Asocimit thuhet se "Shqipëria ka ndërmarrë një varg hapash të suksesshëm në përmirësimin e procedurave për mbikëqyrjen, marrjen në punë dhe trainimet në shërbimin civil dhe janë hedhur gjithashtu hapa në përforcimin e kuadrit ligjor të këtij shërbimi" porse "mbetet akoma shumë punë për t'u bërë në ndalimin e emërimeve të natyrës politike në një shkallë të pranueshme, në përmirësimin e pagave dhe të strukturave të karrierës dhe në futjen e parimeve të menaxhimit në bazë të rezultateve në punë, në mënyrë që të arrihet një rritje në efikasitetin e administratës publike".

Veç të tjerash, Partneriteti European i nëntorit të 2005 përcakton se në një kohë afatshkurtër dhe afatmesme, Qeveria duhet të sigurojë që:

- marrja në punë, transferimi dhe pushimi nga puna i nëpunësve civilë duhet të kryhen sipas Ligjit të Shërbimit Civil;
- për nënpunësit civilë të futen praktikat e menaxhimit dhe të trainimeve në bazë të rezultateve të përfituara nga secili nëpunës; dhe
- struktura e pagave të mundësojë ngritjen e një strukture motivuese për karrierën.

Mangësitë e lartpërmendura trajtohen qartë edhe në Raportin Vjetor 2005 të Departamentit të Administratës Publike. "Megjithë përmirësimet e vëna re në procedurën e konkurimit ... e gjithë procedura e konkurimit ka qenë thellësisht e kompromentuar për shkak të menaxhimit të fazës së tretë të konkurimit dhe të drejtës diskrecionare të eprorit direkt për të zgjedhur një nga tre kandidatët e renditur më mirë gjatë testimit".

Për më tepër, në raport pasqyrohet edhe fakti i mungesës së profesionalizimit në administratën publike dhe prova të qarta për këtë qëndrojnë në "mosrealizimin e objektivave të ndryshme, shtyrjen e afateve për realizimin e tyre, mosplanifikimin realist të objektivave për t'u arritur". Në raport argumentohet se "megjithë përpjekjet për të tërhequr në administratë personel të kualifikuar", deri tani nuk është mundur përmbushja siç duhet e objektivave të ndryshme.


Qëllimi qeverisë është të përforcohen parimet e meritokracisë dhe rendimentit në punë, dhe Programi i Qeverisë parashikon një rritje të nivelit të profesionalizimit në shërbimin civil nëpërmjet:

- konkurrencës së hapur në proceset e rekrutimit dhe të avancimit në karrierë; Departamenti i Administratës Publike ka propozuar disa ndryshime në procedurën e rekrutimit, që synojnë rritjen e objektivitetit në përzgjedhjen e kandidatit më të mirë, siç është rasti i sistemit të konkurimit masiv, ku të gjitha konkurimet për pozicionet e specialistëve do të zhvillohen së bashku për të gjitha institucionet disa herë në vit
- vazhdimin të trainimit profesional; për sa i përket kësaj pike, lind nevoja të ndryshohet procedura e vlerësimit të nevojave për trainime dhe të përputhen më mirë kandidatët me karakteristikat e vendit të punës; në raportin e vitit të shkuar të Stabilizim-Asocimit nxitet "studimi dhe kuptimi i plotë i trainimeve gjenerike për menaxhim, për t'u kryer nga të gjithë nënpunësit civilë në mënyrë që ata të mund të kryejnë detyrat e tyre me më shumë efikasitet"

Përveç kësaj, është përgatitur Dokumenti i Politikave të Pagave dhe Shpërblimeve në institucionet e administratës publike. Në zbatim të dokumentit të politikave, është përgatitur projektligji për pagat në institucionet e pavarura kushtetuese dhe institucionet e tjera të pavarura. Ky dokument politikash përmban kategorizimin e përgjithshëm të të gjitha pozicioneve të punës në institucionet e administratës publike me qëllim: rritjen e konsiderueshme të nivelit të pagave, sipas prioriteteve të qeverisë; të lehtësojë menaxhimin e burimeve njerezore, sidomos në drejtim të mobilitetit; të standartizojë strukturat e institucioneve dhe të krijojë edhe hierarkine institucionale të tyre.

3.3 DECENTRALIZIMI

Autonomia e të ardhurave vendore (%)



Burimi: Ministria e Financave; projekti për Pushtetin Vendor dhe Decentralizimin në Shqipëri (LGDA)

Qëllimi i strategjisë së decentralizimit dhe autonomisë vendore është të zbatojë dispozitat e Kushtetutës së Shqipërisë në lidhje me decentralizimin, në përputhje me parimet e Kartës së Vetqeverisjes Lokale të Këshillit të Europës. Janë katër grupe treguesish që kontrollojnë ecurinë e zbatimit të strategjisë së decentralizimit dhe autonomisë vendore:


- pajtimi me parimet e Kartës Europiane të Vetqeverisjes Lokale;
- tregues krahasues që tregojnë kohëzgjatjen e reformave kyçe;
- matje sasiore e decentralizimit fiskal; dhe
- matje cilësore e perceptimit që kanë qytetarët për pushtetin vendor.

Figura e mësipërme ilustron ecurinë e njërit prej treguesve fiskalë të decentralizimit. Treguesi, konkretisht, është përqindja e të ardhurave totale që shkojnë për financimin e shërbimeve publike vendore (përfshirë edhe transfertat e kushtëzuara) dhe që financohen ose nga burimet e vetë njësjive vendore ose nga transfertat e pakushtëzuara. Diagrama ilustron që pjesa e të ardhurave e cila gjenerohej nga njësitë vendore, ka pësuar rritje nga 6% në vitin 1998 në 50% në vitin 2005. Ndryshimet kryesore kanë ndodhur me shndërrimin e grantit në bllok në transfertë të pakushtëzuar në vitin 2002 dhe veçanërisht me zbatimin e paketës vendore fiskale të vitit 2003. Në tërësi, pjesa e të ardhurave të vetë njësjive vendore përkundëjt totalit të të ardhurave vendore në vitin 2005 ka qenë 21%, ndërsa pjesa e të ardhurave të vetë njësjive vendore përkundëjt totalit të të ardhurave buxhetore në vitin 2005 ishte 4%. Krahasimisht, pjesa e shpenzimeve të njësjive vendore përkundëjt totalit të shpenzimeve publike ishte 17% në vitin 2005.

Për sa i përket politikës së të ardhurave nga qeveritë vendore, Parlamenti ka para tij legjisllacionin për të bashkuar dy taksat e vena bizneseve të vogla në një taksë të vetme që vendoset në nivelin lokal. Aktualisht Qeveria po konsideron masat që do të ofrojnë më të lartë autonomie për qeveritë vendore në përcaktimin e taksave (sidomos kur flitet për taksën e pronësisë), përcaktimin e mekanizmave të reja në akordimin e fondeve të kushtëzuara për investime, gjë që do të eliminojë mospërputhjet e së kaluarës ndërmjet njësjive të qeverisjes vendore, si dhe të kryejë disa ndryshime në ligjin e buxhetit organik për të implementuar një proces buxhetimi të qeverisë vendore me transparent dhe më llogaridhënës.

4 Shteti ligjor

Shteti ligjor (%)



Burimi: Treguesit e Qeverisjes, Instituti i Bankës Botërore

Sipas Raportit të Stabilizim-Asocimit të vitit 2005, edhe pse Shqipëria ka ecur përpara për sa i përket përmirësimit të funksionimit të sistemit gjyqësor, zbatimi i së drejtës penale mbetet i dobët, në lidhje me organizimin dhe transparencën e saj; duhet të sigurohet pavarësia gjyqësore; vënia në jetë e vendimeve gjyqësore, edhe pse është në përmirësim e sipër, është ende e dobët, dhe duhet përmirësuar transparenca.


Matja e këtyre perceptimeve me saktësi është mjaft e vështirë. Një grup matjesh përgjithësisht të pranuar është grupi i Treguesve të Qeverisjes, të cilët llogariten çdo dy vjet nga Instituti i Bankës Botërore. Diagrama e mësipërme raporton treguesin e shtetit ligjor, i cili mat "cilësinë e vënies në jetë të kontratave, policinë dhe gjykatën, gjithashtu edhe probabilitetin e krimit dhe të dhunës".

Duhet theksuar se, ndryshe nga treguesit e tjerë të paraqitur në këtë raport, treguesit e qeverisjes janë subjektivë. Me fjalë të tjera, ata mbështeten në opinione specialistësh, perceptime dhe mbi një sërë pikëpamjesh të studiuar, të cilat mblidhen duke përdorur teknika statistikore. Si rezultat i kësaj, ato janë të manipulueshme. Gjithashtu, këta tregues janë mbledhur në periudha kohore afatgjata. Megjithatë, treguesit mund të jenë të dobishëm për të vëzhguar prirjet afatgjata dhe për të bërë krahasime ndërmjet vendeve.

Diagrama tregon pozicionin e Shqipërisë kundrejt vendeve të tjera të përfshira në mbledhjen e të dhënave. Për shembull, në panelin e majtë tregohet se në vitin 1996 Shqipëria ishte në 40%-shin më të ulët të vendeve por ajo ra në 20%-shin e fundit për sa i përket perceptimit të shtetit ligjor në vitet në vazhdim. Në vitin 2004, nga 209 vende, 25% e tyre rradhiteshin nën Shqipërinë dhe 75% rradhiteshin mbi të. Paneli i djathtë krahason nivelet e treguesit të shtetit ligjor të vitit 2004 midis vendeve të tjera në rajon dhe tregon që Shqipëria renditet akoma më ulët.

4.1 KORRUPSIONI

Kontrolli i korrupsionit (%)



Burimi: Treguesit e Qeverisjes, Instituti i Bankës Botërore


Sipas Raportit të Stabilizim-Asocimit të vitit 2005, korrupsioni mbetet një problem serioz dhe perceptimet e bashkësisë ndërkombëtare për Shqipërinë në lidhje me këtë mbeten negative. Matja e këtyre perceptimeve me saktësi është mjaft e vështirë. Sikurse është përmendur edhe më sipër përsa i përket çështjes së shtetit ligjor, përveç disa objeksioneve, një grup matjesh i pranuar përgjithësisht, është grupi i Treguesve të Qeverisjes, të cilët llogariten çdo dy vjet nga Instituti i Bankës Botërore. Figura e mësipërme paraqet treguesin e kontrollit të korrupsionit, i cili mat "ushtrimin e pushtetit publik për përfitime personale, duke përfshirë si korrupsionin e vogël dhe të madh, ashtu edhe fenomenin e kapjes së shtetit".

Diagrama tregon pozicionin e Shqipërisë kundrejt vendeve të tjera të përfshira në mbledhjen e të dhënave. Për shembull, në panelin e majtë tregohet se Shqipëria ishte në 40%-shin e sipërm të vendeve në vitin 1996 por ra në 10%-shin e poshtëm të vendeve për sa i përket perceptimit të korrupsionit rreth vitit 1998. Shqipëria ka mbetur në vend ndërmjet vitit 2000 dhe 2004. Në vitin 2004, nga 209 vende, 29% e këtyre vendeve klasifikoheshin poshtë Shqipërisë dhe 71% klasifikoheshin mbi të. Paneli i djathtë krahason nivelet e treguesit të kontrollit të korrupsionit në vitin 2004 midis vendeve në rajon dhe tregon se Shqipëria renditet edhe më poshtë.

Sipas Ministrisë së Drejtësisë, në kuadrin e luftës kundër korrupsionit, janë inspektuar në disa gjykata rrethesh si dhe prokuroritë pranë tyre. Në përfundim të inspektimeve të planifikuara të veprimtarisë gjyqësore si dhe administratës gjyqësore u vu re se kishte shkelje të procedurave penale dhe civile të ligjit dhe rrjedhimisht janë propozuar për shkarkim 8 gjyqtarë. Për herë të parë Ministria e Drejtësisë po bën publike të gjitha rezultatet e kontrolleve në gjykata. Nga sektori i inspektimit të Prokurorisë është ushtruar kontroll në prokuroritë e rretheve gjyqësore, dhe rezultatet e kontrolleve i janë përcjelle bashkë me rekomandimet përkatëse Prokurorit të Përgjithshëm dhe Presidentit të Republikës për veprime të mëtejshme.

4.2 KRIMI I ORGANIZUAR

Veprat penale të regjistruara dhe perceptimi i korrupsionit



Burimi: Këshilli i Europës, Raporti i Situatës së Krimit të Organizuar (2005)

Imazhi i Shqipërisë dhe qeverisë së saj do të mund të ndryshojë në sytë e partnerëve dhe publikut të gjerë europian, vetëm nëse lufta e Shqipërisë kundër krimit të organizuar do të ndryshojë në një mënyrë më të efektshme. Sipas Raportit mbi Situatën e Krimit të Organizuar, të publikuar nga Këshilli i Europës në dhjetor të vitit 2005, anëtarët e organizatave kriminale kanë lidhje me biznese të ligjshme dhe me zyrtarë në strukturat e doganës, të kontrollit të zbatimit të ligjit dhe të administratës publike. “Korrupsioni përdoret gjerësisht për të mbrojtur aktivitetet kriminale dhe për të ndaluar ndjekjen penale. Të ardhurat zakonisht përdoren për të zgjeruar bizneset e ligjshme ose për të financuar mjetet e komunikimit, aktivitetet kulturore apo partitë politike”. Raporti për Stabilizim-Asocimin i vitit 2005 i nxiste autoritetet për të bërë përpertime të mëtijshme në zbatimin e masave kundër krimit të organizuar, për shembull për funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave apo për shqyrtimin e dispozitave ligjore për ndryshimin e barrës së provës. “Një pjesë e mirë e ecurisë së Shqipërisë deri tani, në veçanti në fushën e krimit të organizuar, ka konsistuar në fillimin e ngritjes së një kuadri: Shqipëria tani duhet të mbështetet mbi këtë kuadër dhe ta përdorë atë për të arritur rezultate”.


Të pasqyrosh qartë si përmasën e kësaj çështjeje ashtu si dhe të monitorosh sukseset e arritura në luftën kundër krimit të organizuar, është shumë e vështirë. Shifrat e mësipërme pasqyrojnë një prej shumë dimensioneve të problemit në shqyrtim. Diagrama paraqet lidhjen mes Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit të organizatës ‘Transparenca Ndërkombëtare’ dhe masës së standartizuar të rasteve të kundravajtjeve penale të regjistruara në disa vende të përzgjedhura. Sa më shumë të perceptohet një vend si i korruptuar, aq më e vështirë bëhet regjistrimi i rasteve kriminale.

Sipas Ministrisë së Drejtësisë, në ndjekjen penale të krimit të organizuar për 2005, prokuroria pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda regjistroi 25% më shumë procedime se në 2004. Gjatë vitit 2004, Gjykata e Krimeve të Rënda arriti të përfundonte 53 çështje, ndërsa për vitin 2005 kjo gjykatë arriti të përfundonte 74 çështje. Ky shëmbull mund të konsiderohet si një tregues i mirëfunksionimit të luftës kundër krimit të organizuar.

Programi qeveritar synon që të rindërtojë strukturat institucionale që kanë një rol qendror në këtë fushë, të largojë - bazuar në prova - i punonjesve të inkriminuar, të luftojë grupet kriminale të njohura, të vendosë në vend një lidhje të ngushtë bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare, e të përmirësojë Kodin Penal në vendosjen e masave dënuese për raste të tilla shkeljesh penale.

4.3 DREJTËSIA

Ngarkesa e punës dhe cilësia e vendimeve



Burimi: Ministria e Drejtësisë

Në procesin e integrimit europian, sistemi gjyqësor është në qendër të vëmendjes. Ndër të tjera, në nëntor 2005 dokumenti i Partneritetit Europian specifikoi prioritetet e mëposhtme për qeverinë: të rritet transparenca e proceseve gjyqësore penale dhe civile; të garantohet që përzgjedhja e gjykatësve dhe prokurorëve të kryhet në bazë të konkurseve; të ngrihet një sistem transparent dhe meritokratik për vlerësimin e prokurorëve; të vendoset statusi, pavarësia dhe mbrojtja kushtetuese e gjykatësve; të vendosen rregulla objektive në dhënien transparente të çështjeve ndaj gjykatësve; dhe të vendoset një sistem i besuar për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Të gjitha masat e lartpërmendura mund të përmirësojnë dukshëm cilësinë e vendimeve gjyqësore e cila varet nga kushtëzime të tilla si aspektet e përshtatshme organizative dhe kapacitetet shqyrtuese, aftësitë profesionale të zyrtarëve, si dhe nga infrastruktura gjyqësore. Trysnia për rritjen e efikasitetit për sa i përket numrit të gjykimeve për secilin gjykatës në një afat kohor të caktuar, rrezikon të kompromentojë aftësinë e tyre për të vendosur drejtësi në çështje individuale. Gjithsesi, matja e cilësisë së vendimeve gjyqësore është e vështirë.

Në figurën më sipër paraqitet një tregues potencial i cilësisë së vendimeve gjyqësore: proporcioni i vendimeve të gjykatës së shkallës së parë që janë ndryshuar nga gjykata e apelit. Aty tregohet se një rritje në sasinë e çështjeve penale në vitet 2003 dhe 2004 u ndoq me një rritje të fortë të proporcioneve të vendimeve origjinale të cilave u ndryshuan ndërmjet viteve 2004 dhe 2005.

Sipas Ministrisë së Drejtësisë, mbi bazën e studimit për riorganizimin gjyqësor për shkak të shpërndarjes jo proporcionale të volumit të punës, organikave jo të balancuara dhe numrit të madh të delegimeve të gjyqtarëve nga një gjykatë në një tjetër, është hartuar dekreti përkatës, i cili i është paraqitur Presidentit për shqyrtim dhe miratim.

5 Zhvillimi ekonomik dhe njerëzor


Tabela 5.1. Treguesit kryesorë makroekonomikë

	Njësia	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005
Popullsia	Milionë	3.05	3.06	3.07	3.09	3.11	3.13	3.14
Inflacioni (mesatar)	%	0.4	0.0	3.1	5.2	2.4	2.9	2.4
Kursi i këmbimit	Lek / Dollarë	137.7	143.7	143.5	140.2	121.9	102.8	99.9
	Lek / Euro	147.0	132.6	128.5	132.4	137.5	127.7	124.2
Produkti								
Produkti i Brendshëm Bruto (PBB)	Miliardë lekë	480.6	533.0	590.3	631.3	714.0	775.9	836.9
Produkti i Brendshëm Bruto (PBB)	Miliardë dollarë	3.5	3.7	4.1	4.5	5.9	7.5	8.4
Rritja reale e PBB-së	%	13.2	6.5	7.1	4.3	5.7	6.7	5.5
PBB për frymë	Mijë lekë	157.4	174.1	192.0	204.1	229.5	248.1	266.9
PBB për frymë	Dollarë	1143	1212	1339	1456	1883	2414	2673
Financat publike								
Të ardhurat buxhetore gjithsej	Miliardë lekë	123.2	130.6	145.6	154.6	167.2	184.4	204.2
Shpenzimet buxhetore gjithsej	Miliardë lekë	165.7	170.6	186.1	192.5	201.2	222.4	232.3
Defiçiti i përgjithshëm	Miliardë lekë	-42.5	-40.0	-40.4	-37.9	-33.9	-38.1	-28.2
Të ardhurat buxhetore gjithsej	% PBB	25.6	24.5	24.7	24.5	23.4	23.8	24.4
Shpenzimet buxhetore gjithsej	% PBB	34.5	32.0	31.5	30.5	28.2	28.7	27.8
Defiçiti i përgjithshëm	% PBB	-8.8	-7.5	-6.8	-6.0	-4.8	-4.9	-3.4
Borxhi i brendshëm	% PBB	36.9	42.4	40.9	41.3	39.3	38.0	37.7
Borxhi i jashtëm	% PBB	15.8	16.6	17.0	21.7	20.5	18.4	16.8
Bilanci i pagesave								
Bilanci tregtar	Milionë dollarë	-663	-821	-1027	-1155	-1336	-1592	-1887
Eksportet	Milionë dollarë	275	255	305	330	447	603	652
Importet	Milionë dollarë	938	1076	1332	1485	1783	2195	2539
Transfertat	Milionë dollarë	353	533	571	613	842	1109	1014
Rezervat	Milionë dollarë	482	608	754	860	1026	1374	1390
Rezervat - Mbulimi i importeve	Muaj	3.8	4.2	4.6	4.4	3.9	4.1	4.6
Bilanci tregtar	% PBB	-19.0	-22.1	-25.0	-25.6	-22.8	-21.1	-22.5
Rritja e eksportit	%	32.3	-7.2	19.3	8.4	35.4	34.9	8.1
Rritja e importit	%	15.5	14.8	23.7	11.6	20.1	23.1	15.7

Burimi: Ministria e Financave, Drejtoria e Makroekonomisë

5.1 MJEDISI I BIZNESIT

Treguesi i rritjes së konkurueshmërisë (2005-06)




Burimi: Raporti i Konkurueshmërisë Globale 2005-2006

Treguesi i Rritjes së Konkurueshmërisë, i cili është i përfshirë në Raportin e Konkurueshmërisë Globale 2005-2006 të Forumit Ekonomik Botëror, është një tregues kryesor i kushteve konkurruese të ekonomive në mbarë botën. Për herë të parë, për vitin 2005, Shqipëria arrin të renditet ndërmjet vendeve të tjera për këtë tregues. Treguesi i Rritjes së Konkurueshmërisë përbëhet nga tri tregues përbërës: treguesi i teknologjisë, treguesi i institucioneve publike, dhe treguesi i mjedisit makroekonomik. Këta tregues janë përlogaritur si në bazë të dhënave sasiore ashtu edhe mbi bazën e të dhënave të nxjerra nga studimet e opinioneve të shumë drejtuesve të bizneseve. Treguesi i Rritjes së Konkurueshmërisë llogaritet si mesatare e thjeshtë e tre indekseve përbërës. Por, jo të gjitha vëndet e botës janë përfshirë në renditje. Figura e mësipërme tregon që Shqipëria klasifikohet në vendin e 100 ndërmjet 117 vendeve, ndërkohë që ndërmjet vendeve fqinje Bullgaria ka renditjen më të lartë (vendin e 58-të) dhe Bosnje-Herzegovina ka renditjen më të ulët (vendin e 95-të).

Sipas Raportit të Konkurueshmërisë Globale, korrupsioni, infrastruktura e papërshtatshme dhe burokracia e administratës shikohen si pengesa kryesore në Shqipëri. Ndërsa inflacioni, tregu i punës dhe kursi i këmbimit janë më pak problematike. Pavarësisht nga këta tregues, krahasuar me periudhat e mëparshme, konkurueshmëria e ekonomisë shqiptare është në përmirësim, pasi ka disa rezultate pozitive në këto drejtime: përmirësimi i sistemit financiar dhe bankar dhe rritja e aftësisë së tij për të kredituar ekonominë; masat që ka ndërmarrë qeveria në luftën kundër korrupsionit dhe informalitetit në ekonomi; ulja e barrës fiskale për biznesin; nisma e qeverisë për uljen e çmimit të energjisë për biznesin; ulja e barrës së sigurimeve shoqërore për pjesën që duhet të paguajnë sipërmarrësit; ndërmarrja e reformës rregullatore në drejtim të eliminimit dhe thjeshtimit të procedurave administrative ndaj biznesit, veçanërisht për regjistrimin dhe liçensimin; dhe masat në përmirësimin e cilësisë, si çertifikimi, akreditimi, dhe standartet.

Të drejtat e pronës

Zonat kadastrale ku ka mbaruar regjistrimi i parë (2005)



Burimi: Zyra e Regjistrimit të Pronave të Patundshme

Cështja e të drejtave të pronës është kryesore për rritjen ekonomike në Shqipëri. Vazhdimësia e gjëndjes së pasigurisë ndikon në krijimin e mundësive që lindin për investimet e huaja direkte. Tre janë interesat konkrete politike:


- Kompensimi i pronarëve dhe kthimi i pronave: cilat janë kriteret dhe tipet e kompensimeve që ofrohen (dhe cilat janë rrjedhojat fiskale prej tyre)?
- Regjistrimi i pronave: që në 1994 është ngritur Sistemi i Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (SRPP). Megjithatë, puna e këtij sistemi akoma nuk ka përfunduar, sidomos nëse i referohemi zonave me vlerë të lartë. Ky fenomen pasqyrohet edhe në grafikun e mësipërm ku tregohet ecuria e ngadaltë e procesit të regjistrimit në zonat kadastrale urbane. Figura tregon se shumica e pronave të regjistruara ndodheshin në 2263 zonat rurale kadastrale nga 3064 zona në të gjithë Shqipërinë. Edhe pse herë pas here janë regjistruar njësi apartamentesh urbane, regjistrimi i zonave urbane nuk do të ishte i plotë deri sa të kalojnë regjistrimin e parë të rregullt të gjitha pronat e tjera (ngastra toke dhe ndërtesa). Vonesat në regjistrimin e plotë të pronave ndikojnë në mundësinë për kthimin e pronave.
- Legjislacioni mbi vendbanimet informale: ky hap parasheh progres në procesin e regjistrimit të pronave, siç është piketimi i kufijve të tokave, regjistrimi i kërkesave, dhe marrja e masave ndëshkuese duke përdorur të dhëna historike.

Qeveria është e angazhuar të mbajë premtimin e kthimit dhe kompensimit të pronave, të konsolidimit të sistemit të së drejtës së pronës dhe të mundësit të legazimit të pronave. Regjistrat e së drejtës së pronës do të kompiuterizohen dhe institucionet përkatëse përgjegjëse do të fuqizohen që të garantohet respektimi i tyre.

Reforma në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ka nisur me përgatitjen e akteve ligjore të nevojshme për ristrukturimin e zyrës, për ndryshimin e tarifave të shërbimit dhe për përmirësimin e sistemit të pagave. Reforma është përqëndruar në Tiranë, me qëllim që kjo përvojë të përdoret në të gjitha zyrat vendore.

Konkurenca

Treguesi i BERZH-it për politikën e konkurrencës



Burimi: Raporti i Tranzicionit i BERZH-it



	Zyra e Konkurrencës	Cilësia e ligjit për paaftësinë paguese	Ligji për transaksionet e garantuara	Cilësia e ligjit për drejtimin e korporatave
Shqipëria	Po	E lartë	I avancuar	E mesme
Bosnje-Hercegovina	Jo	E lartë	Joefiçent	E ulët
Bullgaria	Po	E lartë	I avancuar	E mesme
Kroacia	Po	E lartë	Joefiçent	E mesme
Maqedonia	Jo	Mesatare	Disa difekte	E lartë
Serbia and Mali i Zi	Jo	E lartë	Disa difekte	E mesme

Burimi: Raporti i Tranzicionit i BERZH-it

Një ndër treguesit që përdoret më shpesh e që vlerëson politikën e konkurrencës në vendet në tranzicion llogaritet nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Ky tregues shkon nga 1 (=nuk ka legjislacione dhe institucione të konkurrencës) në 4+ (=standartet dhe performanca tipike e ekonomive industriale të avancuara: zbatim efektiv i politikës së konkurrencës; hyrje e pakufizuar në shumicën e tregjeve). Vendet me performancën më të dobët ndërmjet vendeve fqinje janë Bosnje-Hercegovina dhe Serbia dhe Mali i Zi. Vlerësimi që i është bërë Shqipërisë nënkupton që janë krijuar legjislacioni dhe institucionet e konkurrencës dhe që është arritur “njëfarë ulje e frenimit të hyrjes apo që janë marrë masa për zbatimin e ligjit për firmat mbizotëruese”. Rivendosja e sistemit të konkurrencës së ndershme përbën bazën e politikave ekonomike të qeverisë. Qeveria do të ndermarrë reforma institucionale e ligjore si dhe do të ngrëjë dhe fuqizojë institucione të specializuara që garantojnë një funksionim të mirë të tregut.

Pengesat administrative

Disa tregues të përzgjedhur të pengesave administrative



Burimi: Studim vetvlerësues, Ministria e Ekonomisë

Burimi: Të bësh biznes në vitin 2006, Banka Botërore Shënim: kolona përfaqëson pozicionin e Shqipërisë; viza tregon zbatuesin më të mirë dhe më të keq ndërmjet Bosnjes, Bullgarisë, Kroacisë, Maqedonisë, dhe Serbisë


Një kuadër i dobët për aktivitetin e biznesit pengon investimet. Me mbështetjen e FIAS, Ministria e Ekonomisë kreu një proces vetvlerësimi në vitin 2002 dhe 2004 për të vlerësuar procedurat e biznesit: regjistrimin, licënsimin, doganën, tatimet, ndërtimin, dhe inspektimet. Proçesi përbëhej nga një studim i institucioneve shtetërore dhe një studim i 500 firmave private, të cilat mblidhnin të dhëna mbi pengesat dhe kostot administrative. *Paneli i majtë* paraqet një nga treguesit që mat problemet e biznesit, përqindjen e bizneseve të studjuara të cilat kanë dhënë rryshfet për disa shërbime. Të paktën një e pesta e këtyre bizneseve pranuan që kishin dhënë rryshfet për regjistrim dhe ndërtim dhe më shumë se dy të pestat pranuan që kishin dhënë rryshfet për importe në doganë. Vetvlerësimi i ardhshëm do të bëhet në vitin 2008.

Paneli i djathtë krahason radhitjen e Shqipërisë kundrejt pesë shteteve fqinje (Bosnje-Hercegovinës, Bullgarisë, Kroacisë, Maqedonisë, dhe Serbisë dhe Malit të Zi) sipas studimit të Bankës Botërore në 155 vende 'Të bësh biznes në vitin 2006'. Studimi 'Të bësh biznes' ndjek një metodikë të ndryshme nga vetvlerësimi: ajo bazohet në një studim të ligjeve dhe rregullave me verifikim nga zyrtarë, juristë dhe specialistë të tjerë të shtetit. Përparësia qëndron në faktin që krahasimet dhe treguesit e krahasimit janë të vlefshme në të gjithë vendet në një bazë vjetore. Nga ana tjetër, ka kufizime, sepse disa matje kanë brenda tyre edhe njëfarë opinionin nga ekspertët që kanë marrë pjesë në anketë. Krahasimi i Shqipërisë me disa vende fqinje tregon që ka përmirësime në fusha si mundësia për të marrë kredi dhe mbyllja e bizneseve por ka përkeqësime në fusha si mbrojtja e investuesve, pagimi i tatimeve dhe zbatimi i kontratave.

Përmirësimi i mjedisit rregullator për biznesin përbën një reformë me përparësi për qeverinë, e cila miratoi një plan veprimi në prill të vitit 2006. Plani i veprimit përcakton katër drejtime kryesore: përgatitjen e një sistemi drejtues të reformës rregullatore; përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues përmes heqjes së pengesave të mbetura për biznesin; përmirësimin e cilësisë së kuadrit të ri rregullator; dhe një mbikqyrje dhe vlerësim sistematik për reformën rregullatore.

Kredia

Kredia për sektorin privat (% PBB)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Ashtu si në të tjera vënde të Europës Qëndrore dhe Lindore, kohët e fundit në Shqipëri ka patur një zgjerim të marrjes së kredisë bankare nga sektori privat. Siç mund të vërehet në grafik, kjo rritje ka qënë e lartë në 2005 kur kredia për sektorin privat arriti në 14.5% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) ndonëse ende mbetet shifra më e ulët në rajon dhe nga të dhënat paraprake të vitit 2006 mendohet që kjo shifër mund të kalojë edhe 20%. Kjo është një shenjë e mirëpritur e thellimit të ndërmjetësimit financiar, e cila përbën në vetvete një fenomen që nxit rritje ekonomike. Kjo pasqyron një rritje të eksperiencës së stafit menaxhues të bankave, një raport besimi në rritje midis bizneseve dhe bankave, përmirësim i gjithanshëm i kushteve sociale dhe ekonomike, dhe i legjislacionit rregullues. Ka patur ndryshime në përbërjen e kredive për t'i kthyer ato në afatgjata dhe proporcioni i kredive në Lek është rritur në 25% të totalit të kredive.


Rritja e shpejtë e dhënies së kredive shkakton edhe një rritje të riskut të kredive për shkak se zgjerimi i portofolit ul mundësinë e bankave për të monitoruar dhe vlerësuar riskun. Mbikëqyrja e pavarur e sistemit financiar është një përgjegjësi e Bankës së Shqipërisë, e cila boton çdo vit një raport mbi sistemin bankar. Në raportin e fundit të Bankës identifikoheshin nevojat e mëposhtme:

- Të thellohet dhe të përmirësohet kuadri i brendshëm rregullator, sidomos në bankat e reja
- Të forcohet zbatimi i rregulloreve
- Të investohet më tej në sistemet e teknologjisë së informacionit

Një plan për zhvillimin e mbikëqyrjes po zbatohet aktualisht nga Banka e Shqipërisë dhe ka për synim standartizimin e procesit të mbikëqyrjes dhe ta transformojë atë në një proces të vazhdueshëm dhe proaktiv të drejtuar në identifikimin e riskut, në veprimet korrigjuese dhe në verifikimin e zbatimit.

5.2 BILANCI I PAGESAVE

Bilanci tregtar




Burimi: INSTAT

Sektori i jashtëm i ekonomisë, gjate vitit 2005, paraqitet me nje bilanc te thelluar negativ në llogarinë korente i shkaktuar nga një deficit i lartë tregtar. Defiçiti tregtar (mallra dhe shërbime) ka arritur në 24% të PBB-së, duke u rritur 4% krahasuar me një vit me parë. Thellimi i defiçitit tregtar në mallra ka ardhur si rrjedhojë e ngadalësimit të rritjes së eksporteve si dhe nga rritja e ndjeshme e importeve. Ky ngadalësim shpjegohet si pasojë e konkurrencës në sektorin e tekstileve me hapjen e tregjeve europiane ndaj atyre kineze dhe indiane. Por faktor shtytës për rritjen e shkallës së mallrave të importuara kanë qënë edhe çmimet e larta të naftës në tregjet ndërkombëtare, ndërkohë që huatë e shtuara kanë nxitur kërkesën për të importuar. Megjithatë, pjesa dërrmuese e kërkesës për të marrë më shumë kredi ka qënë e përbërë nga kërkesa për mallra kapitale, tregues ky pozitiv për nivelin e investimeve, ripërditësimin teknologjik dhe rritjen e produktivitetit. Rritja e aktivitetit kreditues (kredia e re për ekonominë shënoi një rritje vjetore rreth 74%) ka çuar në rritje të importeve me rreth 16%.

Defiçitet e larta tregtare, në vite, janë financuar jo vetëm nga flukset hyrëse të kapitaleve, por mundësi te konsiderueshme financimi janë vërejtur brenda vetë llogarisë korente nëpërmjet dërgesave nga emigrantët. Vlerësohet se mëse 80% e fluksit të transfertave korente (1 miliardë euro) janë kontribut i emigrantëve shqiptarë. Hyrjet neto të kapitalit regjistruan një nivel prej 424 milionë euro, duke mundësuar në masën 71.3% financimin e defiçitit korent dhe rritjen e rezervës valutore me 125 milionë euro.

Struktura e eksporteve

Përbërja e eksporteve



Burimi: Qendra Shqiptare për Tregtinë Ndërkombëtare, raporte të ndryshme për tregtinë e jashtme


Defiçiti tregtar i ka kaluar 20% të PBB-së që nga viti 2000 dhe është rritur në vitin 2005 pasi norma e rritjes së eksporteve u ngadalësua (nga 35% në vitin 2004 në 8% në vitin 2005). Aktiviteti i eksportit është përqëndruar në pesë sektorë edhe pse ka pasur ndryshime gjatë viteve të fundit. Eksportet e tekstileve arritën kulmin në vitin 2000 por përqindja e tyre ka pësuar rënie që atëherë. Eksportet e mineraleve (naftë) dhe të metaleve (krom dhe brava) kanë pësuar rënie gjatë viteve '90 por janë rikthyer me rritje pozitive.

Eksportet e këpucëve, të cilat pësuan një rritje të menjëhershme në fund të viteve '90, kanë mbetur konstante që nga viti 2000. Të gjitha eksportet e këtij sektori gjatë vitit 2004 ishin të drejtuara për në Itali nga ku zakonisht ato ri-eksportohen. Mundësia për rritjen e eksporteve të këpucëve në tregjet europiane është e rëndësishme, si rezultat i avantazheve gjeografike dhe fuqisë punëtore me çmim të ulët.

Programi Qeveritar i identifikon eksportet si një nga burimet kryesore të zhvillimit të ekonomisë shqiptare dhe parashtron politika të ndryshme për nxitjen e eksporteve, duke përfshirë: përmirësimin e standarteve dhe kontrollin e cilësisë; lehtësira tatimore për eksportuesit; nxitjen e investimeve të huaja direkte të orientuara nga eksporti; dhe vazhdimin e politikës së hapjes së tregtisë përmes zbatimit të marrëveshjeve të tregtisë së lirë. Qeveria po punon në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës që ndikon drejtpërdrejt në uljen e kostove të operimit të bizneseve, financimin dhe kreditimin e produkteve me potenciale eksporti, krijimin e skemave të garantimit të eksporteve, dhe fuqizimin e zhvillimit të laboratorëve të akredituar. Gjithashtu, po punohet për ngritjen e një Agjencie Kreditimi të Eksporteve, një institucion i ri financiar, që rrit sigurinë dhe garancinë e kompanive eksportuese; rrit mundësitë për të investuar në prodhimin për eksport dhe i shërben përmirësimit të klimës së biznesit.

Agrobiznesi

Eksportet kryesore bujqësore



Burimi: Qendra Shqiptare për Tregtinë Ndërkombëtare, raporte të ndryshme vjetore të tregtisë së jashtme

Qeveria e konsideron bujqësinë dhe veçanërisht agro-industrinë si një nga tri fushat me përparësi për zhvillimin ekonomik në 10-15 vitet e ardhshme. Sektori i bujqësisë mbulon gati 25% të PBB-së për vitin 2005 dhe afërsisht 50% e popullsisë jeton në zonën rurale. Ky sektor është aktualisht i pazhvilluar dhe përpunohet vetëm një pjesë e vogël e prodhimit vëndas bujqësor. Zhvillimi pengohet nga infrastruktura e dobët, sistemet e dobëta të marketingut dhe të drejtat e pronës të përcaktuara jo mirë, të cilat lidhen me mungesën e një tregu efikas për tokën. Megjithëse mbështetja për fermerin deri tani ka qenë e ulët, vitet e fundit ka pasur rritje në sektorin e agro-përpunimit të prodhimeve blegtorale, të ullirit, farërave dhe perimeve.


Figura tregon prirjet e eksporteve të produkteve kyçe bujqësore. Ullinjtë dhe pijet pësuan rritje të menjëhershme në vitin 2005, ndërkohë që mishi dhe peshku i përgatitur vazhduan rrugën e ngjitjes, duke katërfishuar nivelin e eksporteve brenda shtatë vjetësh. Përkundrazi, nivelet e eksporteve të duhanit dhe peshkut në 2005 mbetën më poshtë se në vitin 1999. Në përgjithësi, eksportet bujqësore janë pothuajse dyfishuar midis vitit 2000 (28 milionë dollarë) dhe vitit 2005 (54 milionë dollarë), edhe pse pjesa e tyre në totalin e eksporteve ka rënë nga 11% në 8%.

Programi qeveritar merr në konsideratë një zhvendosje nga bujqësia minimale për konsum personal drejt bujqësisë së orientuar nga tregu, e përforcuar kjo nga zhvillimi i agro-industrisë si një objektiv kyç. Ndërhyrjet e planifikuara të politikës përfshijnë regjistrimin e tokës për t'i hapur rrugën funksionimit efikas të tregut të tokës, investimet në infrastrukturën bujqësore dhe zgjerimin e shërbimeve shtesë. Zhvillimi i agro-industrisë, e cila është vendimtare për përmirësimin e bilancit të tregtisë së artikujve ushqimorë, do të nxitet me stimuj tatimorë për ndërmarrje të reja agro-industriale. Përveç kësaj, qeveria planifikon përgatitjen e një rrjeti shkollash profesionale në mbështetje të bujqësisë dhe agro-industrisë.

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit po harton dhe kërkon të zbatojë politika nxitëse në lidhje me sigurinë ushqimore, aplikimin e TVSH-së së ulët, sistemin e thertoreve, sistemin e ujitjes dhe kullimit. Vëmendje të veçantë po i kushtohet dhe fondit të investimeve për vreshtarinë si dhe skemave të tjera mbështetëse ku prioritet i jepet sektorit të ullinjve, perimeve dhe blegtorisë.

Turizmi

Numri dhe prejardhja e vizitorëve



Burimi: INSTAT


Edhe pse ka një potencial të madh, sektori i turizmit mbetet i pazhvilluar, i penguar nga infrastruktura e dobët, të drejtat e keq-përcaktuara të pronës dhe kontrolli i dobët i zbatimit të rregullave të ndërtimit. Më sipër janë paraqitur dy grupe treguesish. Në *panelin e majtë*, numri i përgjithshëm i vizitorëve në vit është zbrërthyer sipas qëllimit: pushime, biznes dhe qëndrim i përkohshëm. Të dhënat janë mbledhur në bazë të studimeve tremujore të kryera në pika kufitare. Numri i përgjithshëm i vizitorëve u rrit me 135% midis vitit 2000 dhe 2005. Përqindja e vizitorëve që erdhën në Shqipëri për pushime u rrit nga 50% në vitin 2000 në 75% në vitin 2005. Sipas llogaritjeve të Bankës së Shqipërisë për vitin 2005, shërbimet e turizmit siguruan 692 milion euro, një shumë që i kalon eksportet e mallrave me rreth 30%. Rritja nuk u shkaktua vetëm nga rritja e fluksit të qytetarëve të huaj por edhe nga shpenzimi i emigrantëve që vizituan Shqipërinë. Banka e Shqipërisë ka llogaritur që niveli mesatar i shpenzimit ditor të çdo vizitori ka pësuar një rritje të lehtë.

Paneli i djathtë paraqet një zbrërthim të vizitorëve sipas vendit të origjinës. Statistikat zyrtare grupojnë së bashku vizitorët nga Serbia, Mali i Zi dhe Kosova (SMK). Brenda këtij grupi, vizitorët nga Kosova janë pjesa dërrmuese dhe përbëjnë një përqindje në rritje ndaj numrit total të vizitorëve duke përbërë rreth 50% në 2004, nga 30% që ishte në 2000. Ndryshe nga kjo, raporti i vizitorëve nga Maqedonia (MK), Italia (I), dhe Greqia (GR) ka pësuar rënie. Një prirje interesante është fakti që raportet e vizitorëve nga Europa Veriore dhe Perëndimore (EVP) ashtu si vendet e Europës Qëndrore dhe Lindore (EQL), të cilat janë një grup i synuar në perspektivën afatgjatë, kanë mbetur të palëvizshme.

Programi Qeveritar e citon turizmin si një nga tre sektorët me potencialin më të madh për të kontribuar në zhvillimin afatgjatë ekonomik. Qeveria ka si objektiv zhvillimin e turizmit të interesit të vecantë (kulturor dhe të mjedisit) të kombinuar me turizmin e plazhit dhe të biznesit. Për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të zhvillimit të turizmit, qeveria thekson domosdoshmërinë e menaxhimit të integruar të trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Zbatimi i drejtimeve të përcaktuara në Strategjinë e Turizmit të miratuar në vitin 2002 dhe Strategjinë e Turizmit Kulturor dhe Mjedisor të miratuar në vitin 2006, aktualisht mbështeten nga instrumenta si Plani i Veprimit për Zhvillimin e Sektorit të Turizmit, si dhe hartimi dhe zbatimi i Projektit për Menaxhimin e Integruar të Zonës Bregdetare. Strategjia e Turizmit ka përcaktuar objektivat e mëposhtme për sektorin deri në vitin 2012: 1.25 milionë vizitorë dhe 15% kontribut në PBB.

Investimet e huaja

Investimet e huaja të drejtpërdrejta për frymë (dollarë)



Burimi: Raporti i Tranzicionit i BERZH-it i vitit 2005


'Shqipëria - vendi më tërheqës për investimet e huaja në rajon dhe përtej tij', është një mesazh kyç i Programit qeveritar. Mjedisi i dobët i biznesit në Shqipëri, rezultat i pengesave administrative, korrupsionit dhe kapjes së shtetit, rregullave të dobëta dhe riskut të lartë politik, janë faktorë të mundshëm që shpjegojnë se pse vendi ka një nivel relativisht të ulët të investimeve të huaja direkte (IHD). Figura e mësipërme tregon nivelin e IHD-së për frymë në Shqipëri sipas të dhënave të Raportit të Tranzicionit të BERZH-it për vitin 2005, të cilat mundësojnë krahasimin e Shqipërisë me vendet fqinje. Brenda këtij grupi, Bullgaria kishte vlerën më të lartë të IHD-së për frymë (346 dollarë). Pas Maqedonisë, Shqipëria kishte nivelin më të ulët të investimeve të huaja direkte në rajon në vitin 2005. Të dhënat zyrtare në Shqipëri për IHD-në llogariten nga Banka e Shqipërisë dhe metodat janë duke u përmirësuar vazhdimisht për të përfshirë, për shembull, investimet në pasuritë e patundshme nga emigrantët të paguara drejtpërdrejt firmave të ndërtimit. Të dhënat e Bankës së Shqipërisë, paraqesin një rënie në volumnin e IHD-së prej 24% midis 2004 dhe 2005 nga 278 në 213 milionë euro respektivisht.

Programi qeveritar i vitit 2005 paraqet katër prioritete kryesore të politikës për të tërhequr vëllime më të larta të investimeve të huaja direkte. Së pari, duhet të forcohen demokracia dhe shteti ligjor, dhe të fitohet lufta kundër korrupsionit. Së dyti, qeveria do të kujdeset për një mjedis efektiv tregtar duke pakësuar pengesat administrative, duke modernizuar sektorin financiar, duke zhvilluar infrastrukturën dhe burimet njerëzore dhe duke arritur qëndrueshmëri makroekonomike. Së treti, do të krijohen parqe industriale dhe do t'u ofrohen investuesve stimuj tatimorë. Së fundi, do të përmirësohen rregullat e tregut për të ndihmuar funksionimin e tregjeve të ndershme dhe efikase me pengesa të pakta për të hyrë në to. Do të garantohen të drejtat e pronës.

Janë ndërmarrë masa për trajtimin e barabartë të investitorëve të huaj me ata vendas. Konkretisht, janë unifikuar pagesat për regjistrimin e biznesit në gjykata për investitorët e huaj me ata vendas në fillim të vitit 2006 dhe janë unifikuar pagesat për shërbimet noteriale për investitorët e huaj me ata vendas në fund të vitit 2005. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës ka iniciuar përgatitjen e ligjit për nxitjen e investimeve në Shqipëri. Agjencia e re e Biznesit dhe Investimeve - Albinvest - po punon për rishikimin e strategjisë së nxitjes së investimeve të huaja si dhe përgatitjen e studimeve sektoriale që paraqesin mundësi investimi.

Transfertat private nga jashtë

Volumi i transfertave private nga jashtë, milion euro



Burimi: Banka e Shqipërisë

Transfertat e regjistruara private nga jashtë i kalojnë prurjet nga investimet e huaja të drejtpërdrejta. Llogaritja e shumës së transfertave private nga jashtë është e komplikuar për faktin se një shumë e konsiderueshme nuk kalon përmes sistemit formal bankar. Banka e Shqipërisë i llogarit transfertat private nga jashtë si shumë e transfertave private nga jashtë (remitancave) të regjistruara nëpërmjet sistemit bankar dhe Western Union si dhe një vlerësimi të e transfertave private nga jashtë (remitancave) jashtë këtyre kanaleve duke përdorur një metodologji të përgatitur në bashkëpunim me FMN-në.


Figura e mësipërme tregon se vëllimi absolut i transfertave private nga jashtë është rritur, edhe pse vëllimi i tyre relativ si pjesë e PBB-së ka pësuar rënie që nga viti 2003. Totali i dërgesave nga emigrantët për vitin 2005 vlerësohet të jetë rreth 802 milionë euro ose 11.6% e PBB-së.

Transfertat private nga jashtë kanë ndihmuar për financimin e importeve dhe kanë çuar në një përhapje të shpejtë të sektorëve të ndërtimit dhe shërbimit. Ndikimi i tyre i plotë nuk është parë akoma dhe ato ende përdoren kryesisht për të paguar për konsumin shtëpiak dhe për ndërtimin e banesave se sa për të ndihmuar në kursime dhe investime. Duke marrë parasysh sasinë e madhe të transfertave private nga jashtë dhe faktin që hyrjet mund të pakësohen ndërkohë që emigrantët integrohen më shumë në vendet ku jetojnë, qeveria e ka përcaktuar përgatitjen e një politike koherente për transfertat private nga jashtë si një prioritet. Qëllimet kryesore të ndërhyrjeve të planifikuara në këtë fushë janë rritja e prurjeve së transfertave private nga jashtë përmes rrugëve zyrtare dhe rritja e efektit të tyre zhvillues. E para nga këto kërkon sigurimin e shërbimeve më të mira bankare me produkte financiare të përshtatura për emigrantët. Si pjesë e kësaj, mund të merren në shqyrtim stimuj të tillë për emigrantët siç janë obligacionet e dërgesave dhe llogaritë me normë të lartë interesi. Një efekt akoma më i madh zhvillimi, si edhe tërheqja e më shumë transfertave private nga jashtë në sektorin bankar, kërkon krijimin e lidhjeve më të forta midis transfertave private nga jashtë dhe investimeve. Në veçanti, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mund të përfitonin nga transfertat private nga jashtë nëse fondet do të kalonin në një hua apo skema të mikro-kredisë. Kjo do të ndihmohej nga forcimi i lidhjeve me diasporën për të informuar më mirë shqiptarët që jetojnë jashtë shtetit mbi mundësitë e reja investuese në Shqipëri.

5.3 INFRASTRUKTURA

Transporti rrugor

Vdekshmëria nga aksidentet rrugore



Burimi: INSTAT


Diagrama e mësipërme tregon shkallën e vdekshmërisë nga aksidentet rrugore. Numri i vdekjeve ka mbetur përgjithësisht i pandryshuar. Një tregues i përbashkët për të lejuar krahasueshmërinë midis vendeve përpiket të standartizojë aksidentet nga numri i automjeteve që qarkullojnë në rrjetin rrugor. Ndërkohë që numri i automjeteve është zgjeruar (nga 145 në 285 mijë në periudhën 1998-2005), shkalla e vdekjeve nga aksidentet e trafikut ka pësuar rënie. Megjithatë, kjo shkallë është ende dyfishi i mesatares së vendeve fqinje.

Duhet theksuar se statistikat që masin numrin e automjeteve përfshijnë vetëm ato automjete që kanë targa shqiptare. Programi i Sistemit të Menaxhimit të Incidenteve të Trafikut (TIMS) i Ministrisë së Brendshme llogarit që ka gjithashtu afërsisht 50,000 automjete me targa të huaja që udhëtojnë në rrugët Shqipërisë çdo ditë. Futja në përlllogaritje e këtyre automjeteve do të ulte shkallën e vdekjeve nga 10.8 në 9.2 njerëz për çdo 10,000 automjete. Nga ana tjetër, numri i vdekjeve përfshin vetëm ato vdekje që ndodhin në vendin e aksidentit dhe kështu mund të nënvlerësojë numrin e vdekjeve gjithsej.

Pakësimi i aksidenteve rrugore kërkon identifikimin dhe ndalimin e ngarjes së jashtëligjshme të makinës, përmirësimin e kontrollit të zbatimit të rregullave të trafikut, futjen dhe forcimin e një sistemi inspektimi të automjeteve, riparimin e vendeve të pasigurta në rrugë, përmirësimin e ndihmës së shpejtë si dhe forcimin e fushatave publicitare dhe edukative. Masat e ardhshme kanë për qëllim të afrojnë kushtet rrugore dhe sinjalistikën me nivelet e standarteve europiane. Do të rritet cilësia e kontrollit teknik të mjeteve, duke kompletuar Qendrat e Kontrollit me pajisje bashkëkohore. Proçedurat e auditimit rrugor do të përdoren që nga projekti teknik deri te ndërtimi i rrugëve të reja. Rregullat e trafikut do të përmirësohen, duke dhënë dëshmi aftësie të drejtimit të automjetit të bazuara në proçedura të drejta testimi, si dhe duke edukuar publikun, veçanërisht fëmijët e shkollave, për rregullat e trafikut. Policia rrugore në bashkëpunim me policinë bashkiake do të kontrollojë siç duhet zbatimin e rregullave të trafikut.

Uji

Burimet dhe cilësia e furnizimit me ujë



Burimi: INSTAT, Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS)

Mungesa e një infrastrukture të përshtatshme të furnizimit me ujë përbën një pengesë për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe është faktor kontribues në standartet e ulëta të jetesës. Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS) është një burim i dobishëm informacioni për të dhënat e periudhës 2002-2005 dhe nga të cilat mund të studiohen ndryshimet kryesore ndërmjet zonave rurale dhe urbane.

Për sa i përket *burimit* së ujit, familjeve u është drejtuar pyetja në lidhje me burimin kryesor të ujit të rrjedhshëm që ato përdorin brenda apo jashtë banesës. Përqindja e familjeve që kanë ujë të rrjedhshëm brenda banesave, është më e lartë në zonat urbane. Megjithatë, nuk vërehet ndonjë përmirësim i ndjeshëm gjatë tre viteve të fundit. Në 2005 përqindja e familjeve që furnizoheshin me ujë të rrjedhshëm brenda banesës ishte rreth 87% për zonat urbane dhe 27% për ato rurale. Burime të tjera të ujit për familjet në zonat rurale janë burimet natyrore, pusët dhe çezmat publike.

Për sa i përket *cilësisë* së ujit, përqindja e familjeve që raportojnë që uji nuk është i përshtatshëm për t'u pirë është më e lartë për zonat urbane por ka rënë me 9 pikë në përqindje gjatë tre viteve të fundit (24% në vitin 2005). Nga ana tjetër, në zonat rurale vërehet se përqindja e familjeve që pohojnë se uji me të cilin furnizohen nuk është i përshtatshëm për t'u konsumuar nuk ka ndryshuar. Ndërkohë, gjatë periudhës 2002-2005, përqindja e familjeve që e ziejnë ujin e pijshëm ra si në zonat rurale dhe në ato urbane.


Për sa i përket *vazhdimësisë* së furnizimit me ujë, më shumë se gjysma e familjeve që banojnë në zonat urbane deklaruan që kanë patur furnizim me ndërprerje të ujit. Përqindja e familjeve në zonat rurale që furnizohet me ujë të rrjedhshëm nuk ka ndryshuar gjatë tre viteve të fundit (62% në vitin 2005). LSMS gjithashtu tregon që përqindja e familjeve jo të varfëra që kanë ujë të rrjedhshëm dhe furnizim të pandërprerë me ujë është më e lartë se për familjet e varfëra.

Sipas të dhënave nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, gjatë periudhës 2002-2005, prodhimi i ujit është rritur rreth 76%, ndërsa faturimi është rritur rreth 94%.

Sipas Programit të Qeverisë, duke filluar nga viti 2007, zhvillimi i infrastrukturës ujësjellës-kanalizime do të arrihet nëpërmjet politikës së decentralizimit të shërbimit, duke ia transferuar ato pushtetit vendor, si dhe rritjes së pjesëmarrjes së sektorit privat në këtë shërbim.

Energjia elektrike

Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike (GWh)



Burimi: KESH

Shqipëria edhe gjatë vitit 2005 vazhdoi progresin në fushën e energjisë me reformat organizative e ligjore dhe nëpërmjet investimeve në rrjetet e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes, por kriza e fundvitit 2005 tregoi se kemi të bëjmë me një sistem të zbalancuar.



Diagrama e mësipërme paraqet karakteristikat kryesore të sektorit të energjisë elektrike. Zona e ngjyrosur tregon sasinë e përgjithshme të energjisë së prodhuar. Në thelb, e gjithë energjia elektrike në Shqipëri prodhohet nga hidrocentralet. Prodhimi nuk është rritur gjatë 10 viteve të fundit dhe kushtet jo favorizuese të motit kanë çuar në një rënie të tregut ndërmjet viteve 1999 dhe 2002. Vija e trashë tregon sasinë e energjisë që iu vu në dispozicion rrjetit. Fakti që është nën nivelin e prodhimit deri në fund të viteve '90 tregon se Shqipëria ishte e aftë të eksportonte energji elektrike. Që atëherë, dhe për shkak të rritjes së kërkesës, Shqipëria ka qenë një importuese e energjisë elektrike. Në fakt, që nga viti 1999 është vënë re fenomeni i ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike (zona e katror sipër vijës së trashë); me fjalë të tjera, elektriciteti është ndërprerë në disa linja kur kërkesa e tejkalonte ofertën e burimeve të brendshme dhe të importuara. Kjo situatë e pafavorshme ka të ngjarë të vazhdojë derisa të bëhen investime të reja në kapacitetin prodhues.

Një sektor efikas energjistik është vendimtar për zhvillimin dhe rritjen afatgjatë ekonomike të Shqipërisë. Megjithatë, ky sektor vuan nga nivele të larta humbjeje. Liberalizimi i kufizuar i çmimit ka çuar në modele të paefektshme të përdorimit të energjisë. Përveç kësaj, ndërkohë që burimet e energjisë janë pakësuar, shumë pak është arritur në lidhje me gjetjen e burimeve të reja nëpërmjet marrëveshjeve me ndarje prodhimi.

Programi qeveritar synon të sigurojë furnizim të pandërprerë me energji elektrike brenda vitit 2007 dhe të eliminojë pabarazitë rajonale të furnizimit të energjisë. Qeveria është angazhuar gjithashtu që përdorimi i energjisë të jetë më efikas duke instaluar matësa elektrike, si dhe të përmirësojë disiplinën financiare dhe administrative të KESH-it. Në zbatim të direktivave të Bashkimit Europian, Dokumenti i Politikave të Sektorit Elektrik parashikon: reforma për ristrukturimin e KESH-it; reforma ligjore dhe e çmimeve; dhe reforma për fuqizimin e përgjithshëm të sistemit elektroenergjitik.

Telekomunikacioni

Linjat e telefonit fikse dhe celular




Burimi: INSTAT; Raporti i Tranzicionit i BERZH-it

Një nga trashëgimitë më kryesore nga izolimi i Shqipërisë deri në vitin 1991 janë kushtet e këqija të infrastrukturës së telekomunikacionit. *Paneli i majtë* i diagramës së mësipërme tregon numrin e lidhjeve të telefonisë fikse në raport me popullsinë gjithsej. Shkalla e depërtimit mbetet nën 8% në Shqipëri, që është pothuajse një e pesta e shkallës në disa vende fqinje, siç është Bullgaria dhe Kroacia, dhe një e treta e asaj në Bosnje-Hercegovinë, Maqedoni, dhe Serbi e Mal të Zi. *Paneli i djathtë* tregon zhvillimin e sektorit të telekomunikacionit celular në rajon dhe veçanërisht në Shqipëri që ishte dhe vendi i fundit ku u zhvillua rrjeti.

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit ka iniciuar procedurën ligjore për të ndryshuar ligjin për telekomunikacionet, ndryshim që do të bëjë liberalizimin e plotë të këtij sektori. Njëkohësisht do të përgatiten dhe akte nënligjore, që do të bëjnë klasifikimin e shërbimeve si rezultat i zhvillimit teknologjik. Në vitin 2006 do të hartohet një ligji i ri mbi komunikimin elektronik që do të pasqyrojë edhe Direktivat e Bashkimit Europian.

5.4 ARSIMI

Disa tregues të përzgjedhur të arsimit të mesëm



Source: INSTAT

Një nga karakteristikat kryesore social-ekonomike që e dallon Shqipërinë nga vendet e tjera në rajon, të cilat kanë arritur anëtarësimin në BE, është niveli i ulët i arritjeve arsimore. Siç tregohet në diagramën e mësipërme, ndryshe nga treguesit e performancës ekonomike, treguesit e performancës arsimore kanë ende shumë punë për të rigjetur nivelin e përpara tranzicionit.



Një tregues i rëndësishëm është shkalla bruto e regjistrimit në arsimin e mesëm që tregon numrin e nxënësve që ndjekin klasën e 9-12 që në teori i përket popullsisë së grupmoshës përkatëse (14-17 vjeç). Nga një shkallë bruto e regjistrimit prej 78% në vitin 1989, regjistrimi në arsimin e mesëm është ende vetëm në tre të katërtat të nivelit para tranzicionit. Edhe pse ka një tendencë të fortë në rritje gjatë viteve të fundit, është vënë re një ulje në vitin 2005 deri në nën 60%. Në figurë paraqitet gjithashtu shkalla e regjistrimeve bruto në sistemin e mesëm arsimor sipas të dhënave të mbledhura nga LSMS. Vlerësimet e përlllogaritura nga studimet e familjeve ndryshojnë nga të dhënat administrative për fëmijët që regjistrohen në fillim të vitit shkollor dhe që ikin nga shkolla më vonë gjatë të njëjtit vit akademik. Ndryshimi gjithnjë e më i vogël ndërmjet të dhënave administrative dhe të dhënave të nxjerra nga fazat studimore të familjeve sygjeron një përmirësim të gjendjes së arsimit të mesëm.

Shkalla e ulët e regjistrimit mund të zbërthehet në dy përbërës, të cilët janë të paraqitur edhe në diagramën e mësipërme. Së pari, përqindja e nxënësve që vazhdojnë arsimin e mesëm pas përfundimit të arsimit fillor të detyrueshëm (klasa e 1-8) ka mbetur në vend gjatë tre viteve të fundit në rreth 80%. Së dyti, përqindja e nxënësve që regjistrohen në klasë të 9-të dhe përfundojnë me sukses arsimin e mesëm katër vite më vonë ka qenë në një nivel të palëvizshëm dhe tani po afrohet në 80%.

Politikat që kanë si qëllim rritjen e aksesit në shkolla janë: racionalizimi i shpërndarjes së shkollave; zbatimi i modeleve kurikulare bashkëkohore; vlerësimi dhe raportimi; dhe politika sociale për zonat më të varfra. Për sa i përket rritjes së cilësisë në arsim është përgatitur dhe miratuar marrëveshja 4-vjeçare me Bankën Botërore. Projekti ka këto drejtime kryesore: fuqizimin e lidershit, menaxhimit dhe qeverisjes së sistemit arsimor; përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies; dhe përmirësimin e infrastrukturës shkollore.

5.5 SHËNDETËSIA

Shkaqet kryesore të vdekjes, Shqipëria dhe Bashkimi European



Burimi: Baza e të dhënave "Shëndet për të gjithë" e OBSH


Në panelin e majtë paraqitet proporcioni i të gjitha rasteve të vdekjes së shkaktuar si rezultat i tre shkaqeve kryesore dhe në këtë panel bëhet një krahasim i evoluimit të prirjeve në Shqipëri dhe në vendet e BE-së. Ka pasur një zhvendosje të ndjeshme në shkaqet e vdekjes gjatë periudhës së tranzicionit. Sëmundjet kardiovaskulare dhe kanceri tani janë përgjegjëse për rreth dy të tretat e të gjitha vdekjeve të raportuara dhe janë shkaqet kryesore të vdekjes për popullsinë e rritur. Vdekjet për shkak të kancerit dhe sëmundjeve kardiovaskulare janë rritur me 3 dhe 7 pikë në përqindje përkatësisht, nga 1992 në 2003. Duhet theksuar fakti se prirjet e mësipërme, me shumë gjasë, ndikohen ndjeshëm nga tranzicioni demografik, ose me fjalë të tjera, nga rritja e moshës mesatare të popullatës si pasojë e uljes së lindshmërisë dhe rritjes së jetëgjatësisë. Megjithatë, të dhënat që dëshmojnë mbi shkaqet e vdekshmërisë sipas grupmoshave, gjithashtu konfirmojnë se vdekshmëria nga sëmundjet në rrugët e frymëmarrjes dhe sëmundjet neoplazike (kanceri), është gjithnjë e në rritje për grupmoshën 65-75 vjeç.

Në panelin e djathtë jepet numri i vdekjeve si pasojë e kancerit në organet e frymëmarrjes për periudhën trivjeçare, 2002-2004. Shkalla e vdekjeve nga kanceri mbetet më poshtë nivelit të vendeve të tjera të BE-së. Megjithatë, regjistrimi i rasteve të kancerit të mushkërive tek meshkujt si dhe kancerit të gjirit tek femrat, ka të ngjarë të rritet në vitet në vazhdim, duke pasur parasysh përdorimin e madh të duhanit. Një studim serioz i familjeve për sa i përket konsumit të duhanit, u zhvillua gjatë periudhës tetor 1999 dhe maj 2000, dhe duke u bazuar në direktivat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), u paraqit se 60% e meshkujve dhe 18% e femrave, nga moshë 15 vjeç e lart, pinin duhan. Pavarësisht se përhapja e duhanpirjes ka rezultuar më e ulët nga studimet e mëvonshme të zhvilluara në vitin 2002 dhe 2004, konkluzioni i përgjithshëm është që shkalla e duhanpirjes është shumë e lartë.

Ndryshimet e përmendura në profilin epidemiologjik të qytetarëve shqiptarë theksojnë rëndësinë e ngritjes së një sistemi parandalues shëndetësor. Ministria e Shëndetësisë dhe Insituti i Shëndetit Publik kanë filluar një përpjekje të nxitjes së parandalimit të sëmundjeve kardiovaskulare në shërbimet e kujdesit parësor. Është krijuar një grup pune i luftës kundër kancerit dhe po punohet mbi një projekt afatgjatë të kontrollit të kancerit në bashkëpunim me OBSH-në. Më 2005 është bërë një punë e konsiderueshme për ndërgjegjësimin e politikëbërësve për nevojën e ratifikimit të Konventës për Kontrollin e Duhanit në kuadrin e nismës për kohezion social të Paktit të Stabilitetit.

5.6 STREHIMI

Tregues të situatës së strehimit nga pikëpamja sasiore



Burimi: INSTAT

Niveli i strehimit për çdo qytetar në Shqipëri ishte një ndër më të ulët në Europë pas rrëzimit të sistemit komunist që funksiononte në vend. Aktiviteti ndërtues gjatë viteve të tranzicionit ka gëzuar një rritje të shpejtë. Përmirësimi i cilësisë së strehimit manifestohet në disa mënyra siç është një përmirësim i materialeve të ndërtimit që janë vendosur në përdorim, praktika më të shpeshta të mirëmbajtjes, si dhe akses më i mirë ndaj pajisjeve.


Shifrat e mësipërme paraqesin dy tregues të strehimit nga pikëpamja sasiore. Treguesi i parë është mesatarja e numrit të personave për dhomë. Sipas të dhënave të regjistrimit të përgjithshëm të vitit 1989, kjo mesatare shënonte 2.7 veta për dhomë. Ndërkohë të dhënat nga LSMS të viteve 2002 dhe 2005 regjistrojnë një densitet prej 2.25 persona për dhomë. Me fjalë të tjera ky regjistrim i densitetit të personave për dhomë edhe pse pozitiv, mbetet më i vogël se në vendet e Europës ku regjistrohet një densitet prej 0.5 deri në 1 person për dhomë në Europën Perëndimore, dhe 1 deri në 1.5 persona për dhomë në Europën Qëndrore dhe Lindore.

Treguesi i dytë paraqet mesataren e sipërfaqes së banimit për metra katrorë. Ky tregues ndikohet ndjeshëm nga ndryshimi e çmimeve dhe nivelit të disponueshmërisë së trojeve. LSMS-të e viteve 2002 dhe 2005 tregojnë se sipërfaqja e një vendbanimi është rritur në 20 m², një rritje prej gati 3 m² për frymë krahasuar me vitin 2002, gjë që e çon këtë tregues në nivelin e vendeve të Europës Qëndrore dhe Lindore. Ky raport varion mes 25 dhe 50 m² në vendet e Europës Perëndimore. Megjithëse ka përmirësim në normën e sipërfaqes për person, mbipopullimi i banesave është ende problem dhe tregon nevojën për strehim.

Politikat aktuale të strehimit synojnë të ngushtojnë hendekun që ende ekziston midis kërkesës dhe ofertës në treg për banesa. Instrumentet që synojnë të nxisin oferta të përballueshme konsistojnë në ofrimin e truallit të pajisur me infrastrukturë për zhvillimin e zonave të reja të banimit në qytetet që kanë përqendrim të lartë popullsie. Për grupe popullsie që me të ardhurat e tyre nuk arrijnë të kenë akses në ofertat e përballueshme të tregut, politikat e strehimit parashikojnë banesat sociale me qira dhe ndërtimi i banesave nga vetë banorët në trojet e ofruara me infrastrukturë. Hartimi i standarteve të reja të politikave të strehimit është një nga prioritetet afat-mesme. Këto standarte përfshijnë rishikimin e të drejtës për strehim, konform konventave ndërkombëtare dhe nivelin e përbalimit ekonomik të strehimit nga familjet.

5.7 MJEDISI

Cilësia e ajrit ($\mu\text{g}/\text{m}^3$)



Burimi: Ministria e Mjedisit; standarti i cilësisë së ajrit është $60 \mu\text{g}/\text{m}^3$


Sistemi i mbikëqyrjes së mjedisit përcaktohet nga Vendimi 103 i Këshillit të Ministrave (mars 2002). Sipas këtij vendimi, Ministria e Mjedisit, e Pyjeve dhe e Administrimit të Ujërave duhet të publikojë një raport për gjendjen e mjedisit çdo dy vite, i cili do të paraqesë, komentojë dhe analizojë treguesit e miratuar të mjedisit dhe do të japë rekomandime për përmirësimin e kushteve mjedisore. Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2003-2004 është duke u përpunuar. Instituti i Shëndetit Publik monitoron dhe raporton në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe të Administrimit të Ujërave nivelet e 6 ndotësve të ajrit në stacione të ndryshme në 7 qytetet: Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Vlorë, Korçë dhe Shkodër.

Diagrama e mësipërme paraqet përqëndrimin mesatar vjetor në 4 qytete të 3 ndotësve të ajrit: PM10 (grimcat e imta) mat pluhurin e prodhuar nga djegia e karburanteve dhe aktiviteti ndërtues; SO₂ (dioksidi i sulfurit) është një ndotës i prodhuar kryesisht nga djegia e karburanteve nga automjetet dhe aktiviteti industrial; dhe NO₂ (dioksidi i azotit) është një ndotës i prodhuar nga djegia e karburanteve nga automjetet. Standartet kombëtare për cilësinë mjedisore të ajrit janë miratuar nga Vendimi 803 i Këshillit të Ministrave (dhjetor 2003) dhe janë paraqitur si shirita horizontale. Këto standarte janë vendosur sipas standarteve të BE-së dhe do të ulen më poshtë me kalimin e kohës. Vlerat e direktivave të BE/OBSH janë paraqitur me vija të ndara horizontale. Diagrama tregon se nivelet e grimcave të vogla i tejkalojnë standartet minimale, ndërsa nivelet e dioksidit të sulfurit dhe dioksidit të azotit janë nën standartet minimale. Shifrat për Tiranën dhe Elbasanin janë mesatare të një numri stacionesh matjeje. Diagrama tregon se automjetet, në veçanti ato që janë në përdorim në Shqipëri, kanë zëvendësuar fabrikat industriale si faktorë të ndotjes së mjedisit që nga viti 1990. Kjo do të thotë që vendi po përballet me një problem më të ndërlikuar të ndotjes së mjedisit, pasi lartësia nga toka e tubave të shkarkimit të gazrave të automjeteve gjendet më pranë aparatit të frymëmarrjes së njerëzve, ndërkohë që niveli i ndotësve është më i lartë se normalja, për shkak të vjetërsisë së automjeteve dhe të faktit që mbizotërojnë motorat me naftë.

Politikat për të pakësuar ndotjen e ajrit do të përfshijnë forcimin e sistemit mbikëqyrës (aparaturat, stacionet automatike, frekuenca e mbikëqyrjes) dhe kontrollet teknike të makinave. Dy stacione monitorimi të reja janë shtuar në Tiranë dhe numri i ditëve të monitorimit është rritur në 16 ditë në muaj. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave ka përgatitur disa propozime që synojnë të përmirësojnë cilësinë e naftës dhe benzinës.

6 Roli social i shtetit

Treguesi i zhvillimit njerëzor



Burimi: Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2005

Indeksi i Zhvillimit Njerëzor (IZhNj) është një tregues i mirëqënies i cili ndërthur arritjet e një vendi sipas tre dimensioneve bazë të zhvillimit njerëzor:


- Një jetë e gjatë dhe e shëndetshme, gjë që matet sipas jetëgjatësisë mesatare të popullsisë;
- Niveli i njohurive, i cili matet sipas përqindjes analfabete të popullsisë së rritur dhe sipas shkallës bruto të pranimeve në shkollë, e ndërthurur kjo me tre nivelet akademike; dhe
- Standartet e jetesës, e matur në dollarë sipas produktit të brendshëm bruto (PBB) për frymë bazuar në barazinë e fuqisë blerëse.

Në diagramën e mësipërm paraqitet pozicioni i Shqipërisë në botë i krahasuar edhe me grupin e vendeve fqinjë. Në diagramë krahasohet IZhNj-ja e vendeve fqinjë me PBB-të e tyre për frymë. Ndërmjet 177 vendeve, Shqipëria listohet në vendin e 102-të në termat e PBB për frymë por e 72-ta në termat e indeksit të zhvillimit njerëzor në vitin 2005.

Qeveria e konsideron rolin e saj në çështjet sociale jo vetëm si një obligim, por edhe si një mënyrë efektive për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe social. Faqet që vijojnë listojnë disa prej sfidave të politikave kyçe sociale të Qeverisë.

6.1 TREGU I PUNËS

Shkalla e papunësisë (%)



Burimi: INSTAT

Një përcaktim i saktë i nivelit të papunësisë në vend bëhet shumë i vështirë si pasojë e mbizotërimit të punësimit informal në tregun e punës dhe të aktivitetet bujqësor. Përkufizimi i saktë i të qenit në kërkim aktiv për punë në mënyrë që të kryhet klasifikimi konkret i të papunëve, është një çështje problematike. INSTAT-i ka vendosur në përdorim dy metoda matjeje, të cilat bazohen në dy burime të ndryshme. Metoda zyrtare ka si burim regjistrat e papunësisë që japin numrin e punëkërkuësve të papunë të regjistruar në zyrat lokale të punësimit. Sipas kësaj metode, niveli i papunësisë ka pësuar rënie të vazhdueshme që nga 2001 deri në fund të 2005 e aktualisht është në nivelin 14%. Niveli i papunësisë ndër femra është 5 pikë në përqindje më i lartë se niveli i papunësisë ndër meshkuj.


Nga ana tjetër, studimet të familjeve, siç është Studimi për Matjen e Standarteve të Jetesës (LSMS) janë më e përshtatshme për të bërë dallimin ndërmjet papunësisë si rrjedhojë e kërkimit aktiv të punës dhe papunësisë si rrjedhojë e dekurajimit dhe pasivitetit. Përkufizimi i zakonshëm i papunësisë kërkon që individi të jetë angazhuar në mënyrë aktive në një lloj kërkimi për punë. Përkufizimi i zbutur i papunësisë përfshin edhe punonjësit sezonalë dhe kërkuesit e dekurajuar të punës, të cilët mund të konsiderohen si të papunë edhe pse lidhja e tyre me forcën punëtore është e pakët. Sipas të dy përkufizimeve, shkalla e papunësisë, sipas LSMS, duket se është më e ulët se shifra që jepet nga metoda zyrtare duke shprehur një shkallë të ulët të kërkimit të punës dhe një përqindje të lartë të personave që nuk kërkojnë punë sikurse janë shtëpiaket.

Ky përmirësim i situatës së tregut të punës përkon me zhvillimet e fundit pozitive të rritjes ekonomike. Gjithsesi duhet theksuar se, bazuar në regjistrimin e përgjithshëm të kryer në 2001, 1/3 e totalit të vëndeve të punës ishin të zëna vetëm përkohësisht, në mënyrë sezonale apo të rastit. INSTAT po planifikon të paraqesë një anketë për krahun e punës brenda vitit 2007. Kjo do të përmirësojë mbikëqyrjen e kushteve të tregut të punës.

Gjatë vitit 2005, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka zbatuar programin e shërbimeve të punësimit që përfshin: ndërmjetësimin për punë, këshillimin dhe orientimin për punë dhe profesion, formimin profesional dhe programet e nxitjes së punësimit. Ndërmjetësimi për punë ka qenë dhe për vitin 2005 aktiviteti kryesor i zyrave të punësimit. Njëpërmjet këtij shërbimi bëhet përputhja e kërkesës dhe ofertës. Këshillimi për punë dhe profesion u është ofruar kryesisht të rinjve të cilët futen për herë të parë në tregun e punës dhe personave që kanë humbur punën për shkak të reformave.

6.2 VARFËRIA

Treguesit e varfërisë dhe të pabarazisë, 2002-2005



Burimi: Anketë e Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS)


Shqipëria është një ndër vendet më të varfëra në Europë. Megjithatë shkalla e lartë dhe e vazhdueshme e rritjes ekonomike ndikon pozitivisht në uljen e shkallës së varfërisë. Instrumenti kryesor për matjen e prirjeve të mirëqënies në Shqipëri ka qenë Anketë e Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS). Ky studim ka konsistuar në intervistimin e një grupi të përzgjedhur, përfaqësues në shkallë vendi, të familjeve shqiptare gjatë periudhës 2002-2005. Treguesit e varfërisë janë bazuar në nivelet e konsumit dhe jo të të ardhurave duke qenë se është mjaft e vështirë të sigurohet një informacion i saktë mbi nivelin e të ardhurave personale në Shqipëri. Grafiku dhe shifrat paraqesin prirjet e tre treguesve standard të mirëqënies.

- Shkalla e popullsisë në varfëri absolute është përqindja e familjeve mesatarja e konsumit për frymë të të cilave ka rënë poshtë një nivel të konsideruar si i mjaftueshëm për të përmbushur nevojat bazë të jetesës (vija e varfërisë). Në grafik tregohet se niveli i varfërisë ra ndjeshëm gjatë viteve 2002 dhe 2005, respektivisht nga 25.4% në 18.5%. Rezultatet e Anketës për Matjen e Nivelit të Jetesës tregojnë se niveli i varfërisë ka rënë më shpejt në zonat rurale.
- Shkalla e popullsisë në varfëri ekstreme është përqindja e familjeve mesatarja e konsumit për frymë të të cilave ka rënë poshtë një nivel të konsideruar si i mjaftueshëm për të përmbushur nevojat bazë për ushqim. Ky nivel gjithashtu ka pësuar ulje gjatë periudhës 2002-2005.
- Pjesa e fundit në të djathtën e grafikut tregon se niveli i pabarazisë pësoi njëkohësisht rritje, meqenëse konsumi i pjesës më të varfër të popullsisë (20%) u ul nga 12.7% në 8.2% ndaj konsumit total kombëtar. Lidhja mes rritjes ekonomike dhe pabarazisë është një funksion i ndërlikuar i cili ndryshon në vende të ndryshme sipas kushteve sociale dhe politikave publike.

Në vitin 2005 u miratua ligji i ri i cili parashikon një reformim të sistemit të ndihmës ekonomike. Thelbi i reformimit të sistemit të ndihmës në para konsiston në vendosjen e një korrespondence të drejtë midis vëllimit të nevojave të familjeve dhe masës së fondeve të alokuara nga buxheti qendror drejt qeverisjes vendore. Përveç familjeve të varfëra të cilat plotësojnë kriteret për të përfituar ndihmë ekonomike, duke filluar nga viti 2006 do të zgjerohen kufijtë e përfitimit edhe për kategori të tjera në nevojë. Gjithashtu është parashikuar shpërndarja e ndihmës ekonomike në rastin e kontributit për punët në komunitet.

6.3 MBROJTJA SOCIALE

Norma e varësisë së sistemit të sigurimeve shoqërore



Burimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Për përshkrimin e gjendjes së sistemit të sigurimeve shoqërore përdoren disa tregues:

- Shkalla e zëvendësueshmërisë përfaqëson proporcionin e mesatares së pensioneve përmbi mesataren e rrogave.
- Shkalla e mbulimit përfaqëson proporcionin e numrit të kontribuesve në sigurimet shoqërore përmbi numrin total të fuqisë punëtore, dhe përdoret për të paraqitur shkallën e evazioneve në kontribute.
- Shkalla e vartësisë, e cila pasqyrohet më lart, përfaqëson porcionin ndërmjet përfituesve dhe kontribuesve.


Në figurë tregohet se deri në vitin 2002, numri i përfituesve e tejkalonte numrin e kontribuesve pavarësisht faktit se situata aktuale demografike është favorizuese. Arsyet e këtij fenomeni janë disa:

- Numri i të punësuarve në tregun e punës ka qëndruar i palëvizshëm
- Shkalla e lartë të kontributeve të sigurimeve shoqërore kanë inkurajuar punë-marrësit dhe punë-dhënësit që të shmangin sistemin e sigurimeve shoqërore
- Si edhe faktin se disa kategori të veçanta pensionesh mbulohehin nga mekanizmi kryesor i sigurimeve shoqërore

Kjo situatë është përmirësuar gjatë tre viteve të fundit dhe qeveria ka për synim uljen e evazionit dhe inkurajimin e pagesave të sigurimeve shoqërore nëpërmjet uljes së përqindjeve të kontributeve shoqërore. Veç kësaj, Qeveria e Shqipërisë ka vendosur të zbatojë një plan-veprimi për zvogëlimin e sektorit informal dhe për rrjedhojë, rritjen e numrit të të punësuarve që do të paguajnë sigurime shoqërore.

6.4 FËMIJËT

Shkalla e vdekshmërisë foshnjore



Burimi: INSTAT; Ministria e Shëndetësisë

Shkalla e vdekshmërisë foshnjore, ose me fjalë të tjera probabiliteti që një fëmijë të gjejë vdekjen para se të mbushë një vjeç, është një tregues i cili ndërthur efektet e shumëllojshme të faktorëve të standardeve të jetesës. Për shembull, nëpërmjet këtij treguesi mund të pasqyrohet jo vetëm gjendja e sistemit shëndetësor por edhe mënyra e trajtimit shëndetësor të popullsisë.

Ka dy mekanizma kryesorë të cilët bazohen në të dhënat administrative për matjen e nivelit të vdekshmërisë foshnjore në Shqipëri. Metoda e INSTAT-it, e cila është dhe ajo zyrtarja, bazohet në raportimin e numrit të vdekjeve sipas regjistrave në qendrat e gjendjes civile. Metoda e përdorur nga Ministria e Shëndetësisë bazohet në raportimin e numrit të vdekjeve nga qendrat spitalore dhe klinikat dhe zakonisht është më e lartë se ajo e nxjerrë nga INSTAT-i pasi regjistrimi i rasteve të vdekjeve kryhet në mënyrë më sistematike dhe procesi i regjistrimit nuk varet nga vizitat e personave në qendrat e gjendjes civile. Megjithatë, të dy këta burime tregojnë një prirje në zbritje të numrit të vdekjeve foshnjore. Sipas INSTAT-it, proporcioni i vdekjeve foshnjore gjatë vitit 2004 shënoi masën e 8 vdekjeve për 1000 lindje të gjalla.


Nga ana tjetër, vlerësimi i shkallës së vdekshmërisë foshnjore nga metodat e anketimit të familjeve, siç është studimi MICS, i organizuar nga UNICEF, bazohet në marrjen në pyetje të femrave në grupmoshën 15 - 49 vjeç në lidhje me historikun e kohëve të fundit të lindshmërisë së tyre. Në bazë të këtyre studimeve, paraqitet një mesatare prej 28 vdekjesh për vitin 2000 dhe, bazuar në një vlerësim paraprak, prej 18 vdekjesh për vitin 2005.

Ministria e Shëndetësisë synon ta ruajë këtë prirje të uljes së vdekshmërisë foshnjore, që gjithsesi konsiderohet ndër më të lartat në Europë, duke u përqendruar në: Programin e Planifikimit Familiar në bashkëpunim me Fondin e Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) dhe në krijimin e një departamenti të shëndetit riprodhues në Institutin e Shëndetit Publik (ISHP); në zbatimin në të gjithë vendin të Programit të Menaxhimit të Integruar të Sëmundjeve të Fëmijërisë në bashkëpunim me UNICEF; dhe në Programin e Vaksinimit të Zgjeruar sipas kontratës së nënshkruar me UNICEF dhe futjen në të edhe të vaksinave kundër parotitit epidemik dhe kundër haemophilus influenzae b.

Ministria e Shëndetësisë po kryen integrimin e strukturave shëndetësore të nënës dhe fëmijës në të tre nivelet e kujdesit shëndetësor, po përmirëson cilësinë e shërbimeve përmes unifikimit të protokolleve, dhe po ngre aftësitë teknike të personelit nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm.

6.5 ÇËSHTJET GJINORE

Shkalla e pjesëmarrjes në krahun e punës



Burimi: INSTAT


Krahu i punës në Shqipëri (njerëzit me moshë 15 vjec e sipër të cilët janë ose të punësuar ose të papunë por po kërkojnë punë në mënyrë aktive) u llogarit në 1.3 milion në regjistrimin e popullsisë së vitit 2001 apo 15% më pak se shifra e shënuar në vitin 1989. Gjatë periudhës 1989-2001, krahu i punës humbi më shumë se një të katërtën e femrave dhe 5% të meshkujve. Veç kësaj, në vitin 1989, kishte vetëm disa ndryshime të vogla në pjesëmarrjen në krahun e punës midis meshkujve dhe femrave. Deri në vitin 2001, barazia gjinore ishte zhdukur, pasi vetëm një e dyta e grave ishin aktive në tregun e punës dhe përqindja e grave joaktive ishte dyfishuar. Pjesëmarrja në krahun e punës te meshkujt mbeti afërsisht e njëjtë por përbërja e saj ndryshoi pasi pjesa e të punësuarve u zvogëlua (61% në krahasim me 71% në vitin 1989) dhe pjesa e të papunëve u rrit (14% në krahasim me 6%). Shkalla e krahut mashkullor të punës u ul në shifra absolute si rezultat i emigrimit.

Është e rëndësishme të kihet parasysh se nocionet e punësimit dhe papunësisë kanë ndryshuar që nga viti 1989 dhe nuk është e lehtë t'i krahasosh. Megjithatë, disa ndryshime janë shumë të qarta, siç është rënia e shkallës së pjesëmarrjes së femrave. Përveç shkallës së lartë të emigrimit të meshkujve, duket se femrat nuk i kanë zëvendësuar ata në ekonominë vendase, madje as në fushat apo aktivitetet bujqësore. Punësimi i femrave pësoi rënie më tepër në qytet për disa arsye: mbyllja e fabrikave, rritja e rëndësisë së aktiviteteve të orientuara nga meshkujt siç janë tregtia dhe ndërtimi, dhe migrimi i brendshëm për në qytet. Femrat përballen me më shumë probleme në hyrjen e tregut urban të punës në mjedisin aktual ekonomik.

Matja e punësimit është e vështirë në kontekstin e regjistrimit të popullsisë, pasi nuk është e mundur të drejtohen të gjitha pyetjet e nevojshme në detaje. Në mungesë të një sistemi që studion fuqinë punëtore, ose ndryshe krahun e punës, INSTAT-i përdor dy metoda të tjera për monitorimin e prirjeve të punësimit. Sipas metodës zyrtare, e cila bazohet në një sërë të dhënash dhe supozimesh administrative, shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore mashkullore (për popullsinë meshkuj 15-59 vjeç) është 69%, ose 22 pikë përqindjeje më shumë se shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore femërore (për popullsinë femërore 15-54 vjeç). Ndërkohë, sipas metodës së bazuar në anketimin e LSMS-së të familjeve, pjesëmarrja e fuqisë punëtore femërore e tejkalon shkallën 50%. Për të dyja rastet shpjegimi pas shifrave në fjalë është se mënyra e LSMS-së përfshin një popullsi në moshë pune më të gjerë dhe ka më shumë mundësi të identifikojë punësimin informal. Sipas përkufizimit të LSMS-së, mospërputhja gjinore në shkallët e pjesëmarrjes së krahut të punës është vetëm pak më e theksuar.

6.6 PABARAZITË RAJONALE

Shkalla e vdekshmërisë foshnjore sipas qarqeve



Mesatarja kombetare = 1

Burimi: INSTAT

Zhvillimi i ekuilibruar rajonal përbën një prioritet qeveritar. Çështjet rajonale të cilat kërkojnë vëmendje të veçantë janë të shumta dhe pabarazitë shfaqen në nivele të ndryshme. Diagrama e mësipërme paraqet një dimension të pabarazisë rajonale, shkallën e vdekshmërisë foshnjore. Prirja e saj afatgjatë jepet në Seksionin 6.4.

Numëruesi është numri i vdekjeve të fëmijëve nën moshën 1 vjeç në vitet 2002 dhe 2003 për çdo qark; emëruesi është numri i lindjeve në vitet 2001 dhe 2002 për çdo qark. Arsyeja që dy vitet janë llogaritur së bashku është se, me këto përqindje shumë të vogla, ndryshime të vogla gjatë vitit mund ta shtrembërojnë treguesin. Diagrama paraqet shkallën rajonale të vdekshmërisë së foshnjeve të standartizuar në mënyrë relative me mesataren kombëtare. Ajo tregon se ndërkohë që në disa qarqe, si Gjirokastra dhe Vlora, shkalla e vdekshmërisë foshnjore është më pak se gjysma e normës kombëtare, në të tjerë, si Elbasani dhe Shkoder, shkalla e vdekshmërisë është më shumë se 150% e normës kombëtare. Qarku më problematik, ka 5-fishin e shkallës së vdekshmërisë së qarkut më të mirë. Një problem i ri janë komunitetet suburbane në qytetet e mëdha si Tirana e Durrësi. Një studim i Institutit të Shëndetit Publik (ISHP) në vitin 2005 tregon se fenomeni i diareve dhe infeksioneve respiratore akute në komunitetet suburbane është më e lartë jo vetëm krahasuar me zonën e Durrësit dhe Tiranës por edhe krahasuar me zonat nga ku njerëzit kanë ardhur.

Qëllimi i qeverisë është t'i shpërndajë fondet e caktuara nëpër qeveritë vendore në një mënyrë objektive dhe transparente, me pikësynim zvogëlimin e pabarazive rajonale. Në vijim, politika bazë e uljes së këtyre dallimeve mbetet prioritetizimi i shërbimeve shëndetësore të shpërndara në të gjithë territorin si dhe ruajtja e programeve të shëndetit publik për të gjithë popullatën. Disa nga politikat aktuale në këtë drejtim janë:

- Pagesa më të larta për personelin shëndetësor që punon në zonat rurale
- Infrastruktura shëndetësore në zonat e varfëra dhe të pafavorizuara
- Programe trajnimi për punonjësit shëndetësorë komunitarë në zonat e pafavorizuara.
- Planifikim më i mirë i burimeve njerëzore dhe burimeve të tjera shëndetësore

Aneksi 1 Disa tregues të përzgjedhur të monitorimit

Tabela A1.1 Objektivat kryesorë të SKZHES-së

Objektivi (njësi)	Fakti					Objektivi 2006
	2001	2002	2003	2004	2005	
Rritja						
PBB për frymë (dollarë)	1339	1456	1883	2414	2673	2660
Rritja e PBB-së (%)	7.1	4.3	5.7	6.7	5.5	6.0
Defiçiti buxhetor në raport me PBB-në (%)	6.8	6.0	4.8	4.9	3.4	5.0
Norma e inflacionit (%)	3.1	5.2	2.4	2.9	2.4	3.0
Varfëria						
Përqindja e varfërisë absolute (%)		25.4			18.5	20.0
Përqindja e varfërisë së skajshme (%)		4.7			3.5	3.0
Shkalla e papunësisë (%)	16.4	15.8	15.0	14.4	14.1	12.0
Shëndetësia						
Vdekshmëria foshnjore për çdo 1000 lindje	17.4	17.5	15.5	15.1	14.7	15.0
Vdekshmëria e nënave për çdo 100 000 lindje	22.7	25.9	21.3	12.0		15.0
Arsimi						
Shkalla e shkollimit të banorëve nga mosha 15-24 vjeç (%)	98.4					98.8
Raporti i femrave dhe meshkujve të shkolluar të moshave 15-24 vjeç						
Qytet (%)	90					
Fshat (%)	87					
Shkalla e përfundimit të arsimit fillor (%)	97	98	98	97		99
Shkalla e regjistrimit të përgjithshëm në arsimin e mesëm (%)	38	42	50	51	53	50
Pjesa e regjistrimit në arsimin e mesëm profesional (%)	16	16	16	16		30
Numri mesatar i viteve të shkollimit	9.5		10.5			10.8
Qeverisja (0-100)						
Shprehja e mendimit dhe llogaridhënia		47.5		48.1		
Stabiliteti politik		29.7		16.5		
Efektiviteti i qeverisjes		37.3		40.9		
Cilësia rregullatore		42.9		48.3		
Shteti ligjor		17.9		25.1		
Kontrolli i korrupsionit		23.5		29.1		

Tabela A1.2 Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, disa tregues të përzgjedhur

Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit dhe treguesit	Burimi	2001	2002	2003	2004	2005	Qellimi 2015
OZhm 1: Zhdukja e varfërisë së skajshme, urisë dhe dimensioneve të tjera të varfërisë							
Pjesa e 20%-shit më të varfër në konsumin kombëtar (%)	LSMS		12.7			8.2	
Përqindja e varfërisë absolute (%)	LSMS		25.4			18.5	13.0
Përqindja e varfërisë së skajshme (%)	LSMS		4.7			3.5	0
Përqindja e fëmijëve nëneshë, të fëmijët nën 5 vjeç (%)	LSMS		14.0				8.0
Shkalla e papunësisë	INSTAT	16.4	15.8	15.0	14.4	14.1	10.0
OZhm 2: Arsimit fillor i cilësisë së lartë për të gjithë							
Shkalla e përgjithshme e regjistrimit në arsimin fillor [1-4] (%)	INSTAT		92.5	94	95	89	100
Shkalla e përgjithshme e regjistrimit në arsimin tetëvjeçar [1-8] (%)	INSTAT				93	94	100
Shkalla e përfundimit të arsimit fillor [1-4] (%)	INSTAT		88			98	
Shkalla e përfundimit të arsimit tetëvjeçar [1-8] (%)	INSTAT		98	98	97	98	
Shkalla e braktisjes së arsimit fillor [1-4] (%)	INSTAT		2	2		0.5	0
Numri mesatar i viteve të shkollimit	INSTAT			10.5			
OZhm 3: Përkrahja e barazisë gjinore dhe fuqizimit të gruas							
Raporti i vazhimit me djemtë në arsimin fillor [1-4]	MASH			0.94	0.93	0.93	1
Raporti i vazhimit me djemtë në ciklin e lartë të arsimit tetëvjeçar[5-8]	MASH			0.92	0.94	0.94	1
Përqindja e vendeve të zëna nga femrat në parlamentin kombëtar		5.7	5.7	5.7	5.7	7.1	30.0
Pjesa e femrave të punësuar me rrogë në ekonominë jo-bujqësore (%)	INSTAT		32.6			32.4	50.0
OZhm 4: Ulja e vdekshmërisë së fëmijëve							
Vdekshmëria foshnjore për çdo 1000 lindje	INSTAT		17.5	15.5	15.1	14.7	10.0
Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç për çdo 1000 lindje	INSTAT		20.1	20.7		19.0	10.0
Përqindja e fëmijëve të vaksinuar kundër fruthit (%)	MSH		95	94		97	95
OZhm 5: Përmirësimi i shëndetit të nënave							
Vdekshmëria e nënave për çdo 100 000 lindje	MSH		25.9	21.3	12.0	23.0	11.0
Përqindja e vizitave të nënave shtatzëna në tremujorin e parë të barrës (%)	MSH		42	47		60	70
OZhm 6: Lufta kundër HIV/AIDS dhe tuberkulozit							
Shkalla e përhapjes së HIV te të rriturit (15-49)	MSH					<0.1	
Numri i personave që bëjnë në mënyrë vullnetare analizat e HIV	MSH			250	350	1000	50,000
Shkalla e njoftimit të tuberkulozit për çdo 100,000 banorë	MSH			20	20	18	
Shkalla e vdekshmërisë nga tuberkulozi (%)	MSH			4.5	3.5	3.5	2.5
OZhm 7: Garantimi i zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor							
Toka e mbrojtur për të ruajtur diversitetin biologjik (%)	MMPAU		3.6	5.8	6.3	8.3	
Toka e mbuluar nga pyje (mijë hektarë)	MMPAU		991			1041	
Popullsia që ka ujë të pijshëm të parrezikshëm (%)			69.0	75.4		81.3	98.0
Popullsia që ka kanalizime të përmirësuara (%)			63.8	68.3			95.0

OZhm 1: Eliminimi i varferisë ekstreme, urisë dhe dimensioneve të tjera të varferisë

1. Të përgjysmohet ndërmjet 2002 dhe 2015 përqindja e njerezve që jetojnë në varferi ekstreme
2. Të zvogelohet ndërmjet 2002 dhe 2015 përqindja e njerezve që vuajnë nga kequshqyerja
3. Të ulet papunësia ndërmjet 2002 dhe 2015 duke arritur standartet e BE
4. Të sigurohet një sistem i hapur tregtar dhe financiar për një rritje ekonomike gjithëpërfshirëse
5. Të bëhet i mundur përdorimi i teknologjive të komunikimit dhe informacionit
6. Të rritet mundësia e furnizimit me energji elektrike për të gjithë

Të dhënat e LSMS-së për vitin 2005 shënuan një progres domethënës drejt zbutjes së varfërisë që do të mundësojë arritjen e objektivave nga Shqipëria. Moduli i rritjes rezultoi i suksesshëm duke shpëtuar mijëra njerëz nga varfëria. Ulja e varfërisë ka qenë më e dukshme në Tiranë, në zonat urbane (në krahasim me ato rurale) dhe në zonat malore (në krahasim me zonat bregdetare dhe ato qendrore).

Megjithatë, papunësia mbetet e lartë dhe shpërndarja është përkeqësuar. Konsumi i përgjithshëm i një të pestës së pjesës më të varfër të popullsisë në 2005 është katër përqind më i ulët në krahasim me 2002. Ekziston rreziku që varfëria, edhe pse në ulje, mund të hedhë rrënjë në disa vende dhe përjashtimi mund të kthehet në një problem të vërtetë. Kjo do të krijojë nevojën e politikave që trajtojnë përjashtimin:

- për t'u mundësuar njerëzve akses në të drejtat, burimet, dhe mundësitë përmes politikave që plotësojnë politikat e rritjes dhe që fokusohen mbi grupet e prekshme (në zonat e paprivileguara, Romët dhe Egjiptianët, të rinjtë, grate e rrezikuara etj.);
- përmes promovimit të ekonomisë sociale që bashkon objektivat sociale me shpirtin e biznesit

Shqetësimet në rritje për shpërndarjen kërkojnë ngritjen e një sistemi monitorimi që t'i kushtojë më shumë vëmendje përjashtimit. Strategjia e përfshirjes sociale, e cila aktualisht është në përgatitje e sipër, prezanton një seri treguesish të huazuar nga Bashkimi Europian, që do të lejojnë një analizë më të thellë të çështjeve binjake të varfërisë dhe shpërndarjes.

OZhm 2: Arsimit baze i një cilësie të lartë për të gjithë

7. Të arrihet ndjekja e arsimit baze nga vajzat dhe djemte 100% deri në 2015
8. Zbatimi i masave që do të sjellin një përmirësim të cilësisë së arsimit primar
9. Përafrimi i treguesve financiarë për arsimin baze në të njejten linjë me vendet e OECD

Shifrat e regjistrimit neto në Klasat 1-4 (89%) dhe Klasat 1-8 (94%) për vitin 2005 tregojnë se Shqipëria nuk është në ritmin e duhur për realizimin e synimeve të OZhm dhe për këtë arsye duhen marrë masat e duhura. Nga ana tjetër, numri i përfundimit (me fjalë të tjera, pjesa e nxënësve që fillojnë Klasën 1 dhe arrijnë Klasën 5) (98%) dhe numri i braktisjeve (0.5%) të arsimit fillor, janë të kënaqshme.

Problemi i ndjekjes së arsimit fillor kërkon politika që trajtojnë çështjen e përjashtimit. Këto politika duhet të përfshijnë ri-projektim të shërbimit arsimor sipas ndryshimeve demografike si në zonat rurale ashtu edhe në ato urbane, si edhe t'u kushtohet vëmendje grupeve të prekshme. Gjithashtu, duhen përmirësuar treguesit e hartuar për të mundësuar monitorimin e grupeve të prekshme.

Nuk ekzistojnë të dhëna të besueshme mbi cilësinë e mësimdhënies në shkollat fillore, por informacioni gojor sygjeron se kjo po kthehet në një çështje vërtet shqetësuese, sidomos në zonat rurale. Besueshmëria e ulët tek mësuesi ndikon mbi këtë problem dhe kërkon progres të mëtejshëm të reformës së decentralizimit. Po kështu, rritja e parashikuar e shpenzimeve publike për arsimin duhet të përdoret edhe për financimin e materialeve të mësimdhënies.

OZhm 3: Nxitja e barazisë gjinore dhe pjesëmarrjes së gruas në vendimarrje

10. Eliminimi i diferencave gjinore në arsimin fillor dhe tetëvjeçar, mundësisht në vitin 2005
11. Eliminimi i diferencave gjinore në zgjedhjet për organet dhe pozicionet e vendimarrjes

Pas zgjedhjeve parlamentare 2005, numri i vendeve të zëna nga gratë u rrit disi, edhe pse jo mjaftueshëm për të krijuar besimin që objektivi i vitit 2015 për 30% parlamentare femra mund të arrihet. Përfaqësimi i pamjaftueshëm i grave në politikë si një problem gjinor nuk është shndërruar ende në një çështje publike.

Duket se ndërgjegjësimi publik mbi çështjen e vajzave që braktisin shkollën nuk është i mjaftueshëm. Në zonat rurale vazhdon të ekzistojë një mentalitet diskriminues kundër vajzave që dëshirojnë të vazhdojnë shkollën, ndërkohë që në këto zona nuk ka programme specifike për zbutjen e pabarazive.

OZhm 4: Reduktimi i vdekshmërisë foshnjore

12. Reduktimi i nivelit të vdekshmërisë së fëmijëve nën pesë vjeç me 10/1000 deri në 2015

Ekziston një tendencë rënieje e shkallës së vdekshmërisë foshnjore: nga 17.5 për një mijë lindje të gjalla më 2002 në 14.7 më 2005. Nëse vazhdon të mbahet kjo shkallë në rënie, atëherë do të mund të arrihet objektivi i vitit 2015. Megjithatë, duhet theksuar se objektivi i vdekshmërisë foshnjore nuk është aq ambicioz sa duhet, duke qenë larg nivelit të BE. Shkalla e rënies së vdekshmërisë për moshat nën 5 vjeç nuk është aq e shpejtë sa duhet: nga 20.1 për një mijë lindje të gjalla më 2002 në 18 më 2005. Me të dhënat aktuale, objektivi, i cili është tepër larg nivelit prej 5.4 të Bashkimit Europian, nuk do të realizohet.

Shkalla e fëmijëve të vaksinuar kundër fruthit tashmë e ka kaluar synimin, që qëndron shumë më lart së mesatarja Europiane prej 86.9%.

OZhm 5: Përmirësimi i shëndetit të nënës

13. Reduktimi deri në përgjysmim i nivelit të vdekshmërisë amëtare deri në 2015

Nuk ka një tendencë të qartë në kohë për shkallën e vdekshmërisë së nënës (12 në 100,000 lindje të gjalla më 2004 dhe 23 më 2005) por në përgjithësi ka të ngjarë që objektivi i 2015-ës të mos realizohet, pavarësisht faktit që vetë objektivi ishte parashikuar shumë më lart se niveli i BE-së.

Shkalla e vizitave të para-lindjes demonstron të njëjtën linjë variacioni në kohë, duke vënë në dyshim nëse Shqipëria do të mund të arrijë objektivin prej (70%) në 2015.

OZhm 6: Lufta kundër HIV/AIDS dhe tuberkulozit

14. Të ndalet dhe të përmbysset përhapja e virusit të HIV/AIDS deri në 2015
15. Të ndalet dhe të përmbysset norma e deklarimit të tuberkulozit deri në 2015

Shqipëria konsiderohet akoma si një vend me shkallë të ulët të përhapjes së HIV/SIDA-s: shkalla e përhapjes HIV midis të rriturve për vitin 2005 vlerësohet të jetë më pak se 0.1%. Numri i personave që bëjnë vullnetarisht testin HIV në 2005 (1000 vetë) ishte shumë më poshtë se objektiv i 2015. Për kontrast, numri i prezervativëve të shpërndarë është rritur shumë shpejt. Është tepër e rëndësishme të zgjerohet mundësia për të bërë testin HIV duke përmirësuar infrastrukturën dhe duke trajnuar personelin mjekësor jashtë Tiranës. Përfshirja e mediave, përmirësimi i edukimit seksual në shkolla, intensifikimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere mbi virusin HIV për publikun e gjerë, përmirësimi i kuadrit ligjor, dhe krijimi i informacionit të veçantë dhe sistemit të duhur të menaxhimit, do të kontribuonte për një sistem akoma më efikas të monitorimit të HIV-it. Për sa u përket treguesve të tuberkulozit, rastet dhe shkalla e vdekshmërisë tregojnë se objektivat e caktuara do të arrihen.

OZhm 7: Sigurimi i zhvillimit të qendrueshëm mjedisor

16. Përfshirja e parimeve të zhvillimit të qendrueshëm në politikat dhe programet e vendit dhe kompensimi i humbjeve të burimeve natyrore;
17. Reduktimi i përqindjes së njerezve pa akses në ujë të pijshëm dhe infrastrukturën përkatëse të kanaleve të ujerave të zeza

Është shënuar progres drejt rritjes së sipërfaqes së mbrojtur të tokës në funksion të ruajtjes së diversitetit biologjik. E gjithë sipërfaqja e tokës së mbrojtur është rritur në mënyrë të ndjeshme gjatë viteve të fundit, nga 3.6% të sipërfaqes së vendit në 2002 në 8.3% në 2005. Megjithatë, sasia e zonave të mbrojtura mbetet e pamjaftueshme për të siguruar ruajtjen efektive të diversitetit biologjik të vendit. Po kështu, integriteti biologjik i zonave të mbrojtura ekzistuese po kompromentohet nga gjuetia, peshkimi dhe prerja e paligjshme e pyjeve.

Zona pyjore është rritur me 50,000 hektarë midis viteve 2002-2005. Në 2005, sipërfaqja e përgjithshme e tokës pyjore ishte 1.041 milionë hektarë, duke shënuar rreth 36% të totalit. Me transferimin e menaxhimit të pyjeve komunave, prerja e paligjshme e pyjeve është ulur, edhe pse vazhdon të mbetet problem. Qeveria synon të vazhdojë politikën e saj për inkurajimin e pjesëmarrjes së komunitetit në menaxhimin e pyjeve dhe kullotave.

Furnizimi me ujë të pijshëm është përmirësuar gjithashtu. Në 2005, 81.3% e popullsisë kishte furnizim me ujë të pijshëm në krahasim me 63.8% në 2002. Sistemi monitories bazohet mbi LSMS. Tendenca aktuale sygjeron se Shqipëria do të mund të realizojë objektivat e saj për ujë të pijshëm, por sektori po çalon për shkak të një reforme me ritme të ngadalta.

Ndotja e ujit dhe e ajrit vazhdojnë të jenë problematike. Pjesëzat e pluhurit të pranishme në ajër janë 2.5-3 herë më të larta nga standartet europiane. Ndotja e ujit me plehra të lëngshme urbane, kryesisht e Detit Adriatik, përbën një problem kryesor.

OZhm 9: Ngritja dhe forcimi i një procesit të mirë për qeverisjen

19. Reformimi i gjithë sistemit shtetëror të administratës publike, legjislacionit dhe politikave, në përputhje me standartet drejtësisë së BE-së, shtetit të së drejtës, dhe ekonomisë së tregut deri në 2015

Shqipëria ka pasur një progres të ngadaltë drejt përmirësimit të sistemit qeverisës së saj ashtu siç tregohet nga gjashtë treguesit e qeverisjes të matura nga Instituti i Bankës Botërore. Treguesit e qeverisjes në Shqipëri janë shumë më poshtë mesatares së Europës Juglindore, ndërsa 4 nga 6 tregues, ku përfshihen rendi dhe kontrolli mbi korrupsionin, pozicionohen poshtë kategorisë mesatare të vendeve me të ardhura të ngjashme.

Siç shihet, ritmi i përmirësimit të qeverisjes tregon se Shqipëria nuk do t'i arrijë objektivat e vendosura. Progresi i përshpejtuar ka nevojë për reformë të thellë të institucioneve publike që në fakt përkon me procesin sfidues të integritimit Europian.

Përveç Treguesve të Qeverisjes Botërore, nuk ekziston asnjë sistem monitories në vend. Është i nevojshëm zhvillimi i një sistemi të dytë me tregues të qeverisjes, që do të jenë specifike dhe të ndjeshëm ndaj veprimeve të ardhshme politike.

